


BIBLIOTEKA
SHTETIT

834-32
847



TRIMAT
E PAMPOSHTUR
TË MILISKAJËS


FATMIR
DIBRA

81H-32

042

FATMIR DIBRA

TRIMAT E PAMPOSHTUR TË MILISKAJËS



Biblioteka e Shtëpitës Gjergja Asteri
Shtëpia Botuese «8 Nentori»
Tirana 2000 vjetore

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tirane, 1977

TRIMAT E PAMPOSHTUR TË MILISKAJËS

Fierza papritur u zhyt në një errësirë të thellë. Pushoi së rrahuri pulsi gjigant i punës. Heshtën tornot, u ndalën kompresorët e ajrit, fabrika e betonit ndali prodhimin, promekset e shpimit të hidrocentralit pushuan. Gjithshka pushoi atë ditë janari. Në për shtëpi u ndezën llampat e vajgurit dhe diku qirinj. Energjia elektrike ishte ndërprerë. Dëbora vazhdonte të binte pa pushim, mjegulla po dendësohej dhe si një qenie e padukshme mbuloi tërë atë kantier të madh pune. Ishte prerë arteri i energjisë, pa të cilin nuk mund të rronte kantieri i madh i pesëvjeçarit. Telat e tensionit, të veshur me akull të trashë nga lëkundjet e mëdha, ishin këputur. Po ku, në cilin kilometër të saj?

Ekipazhi i nënstacionit elektrik të Fierzës u nis në kërkim përmes dëborës dhe akullit, për t'i gjetur ato fije të këputura. Të tjerët nisën punën për zë-vendësimin e izolatorit të dëmtuar në nënstacion. Njerëzit e kantierit të drithës, të shqetësuar, të mbuluar nga dëbora dhe mjegulla në lartësitë e fshatit Gropaj, gjetën disa fije të këputura: ato dergjeshin të mbuluara nga një shtresë e trashë dëbore. Kjo i gëzoi ata njerëz të heshtur. Pas lidhjes plot mundim

në atë kohë acari, një radist u mundua të lidhej me Fushë-Arrëzin:

— Alo, Alo! Këtu Fierza. Lëshoni energjinë elektrike! Difekti është rregulluar.

Më kot atje në Fushë-Arrëz u munduan të lëshonin energjinë elektrike. Fierza nuk po ndriçohej. Kantieri mbeti në errësirë të plotë.

— Alo, Fushë-Arrëzi, Fushë-Arrëzi! Nuk kemi dritë. Lëshoni energjinë elektrike, — fliste radisti i shqetësuar.

Fushë-Arrëzi u mundua të lëshonte dritën, por s'ia doli mbanë. «Difekt tjetër? S'është e mundur», «Jo, s'duhet të ketë difekt tjetër!»! Këto ishin zërat e shqetësuar të njerëzve të kantierit të dritës, të cilët pyesnin, shqetësoheshin për punën, për kantierin e tyre, që në këtë acar janari kish heshtur. Po sa do të vazhdonte kjo heshtje? Për 48 orë askush nuk mori ndonjë përgjigje. Orët! Sa të shtrenjta ishin ato për kantierin e madh të punës atje në Fierzë!

Nga Tirana u nis një ekipazh specialistësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Centraleve Elektrike. Por tutje Fushë-Arrëzit, në drejtim të Fierzës së dërgët, makina u ndal. Kudo dëborë dhe vetëm dëborë. Nuk mund të çahet ajo masë e bardhë, që dukej e pafundme:

— Do të ecim në këmbë, — tha Vangjeli.

Në këmbë! Për një çast ata njerëz të veshur me gozhupa të rëndë panë njëri-tjetrin në sy. E kuptuan se rrugë tjetër nuk kishte. Po. Në këmbë dhe vetëm në këmbë duhet, të çanin përpara për të gjetur difektin.

— Nisëmi! — tha Beqiri, elektricisti i talentuar.

— Po, po, — thanë edhe të tjerët.

Kolotta lëvizë, Ajo e cte vazhdimisht, pa u nda-

lur, përpara, duke hedhur vështrimin nga dëbora, nga panorama e bardhë që të vriste sytë. Ata ecnini duke lënë gjurma të thella në dëborë, të cilat sakaq mbuloheshin përsëri nga dëbora; që binte me flokë të mëdha dhe të shpeshtë.

Në krahun e tyre të djathjtë dukeshin telat e tensionit të lartë të veshur me akull, por askund nuk dukej shenjë këputjeje. Vallë, ku do të jetë bërë këputja? Kjo ishte pyetja që u värtitej në kokë udhëtarëve të guximshëm të asaj dite të ftohtë dëbore. Por ata vazhdonin të ecnin, pa mundur të gjenin një përgjigje.

Papritmas dikush qëndroi dhe ju drejtua shokëve.

— Shikoni këtej, shikoni telat e këputur! — zëri i tij erdhi kaq papritmas, sa të tjerët për një çast u shtangën.

— Ja ku janë, — vijoi zëri i parë.

Vangjeli, Beqiri, Fejziu u ndalën e ngulën sytë mbi telat e këputur. Dhe për çudi në fytyrat e tyre nuk u pasqyrua asnjë shenjë gëzimi, por përkundrazi dëshpërimi ua mbuloi fytyrat e lodhura dhe të hequra nga ajo rrugë plot mundime.

— Ah, vetëm këtu të mos ishin këputur! — tha i dëshpëruar njëri nga pjesëtarët e ekipazhit.

Ishin te Shkëmbi i Miliskajës, një nga më të thepisurit në vendin tonë dhe që ngrihej si me kryeneçesi mbi atë humnerë të rrezikshme.

Nga kjo shtyllë e hekurt e tensionit të lartë e deri tek shtyllat e anës tjetër të humnerës kishte një kilometër linjë ajrore. Një kilometër tel i trashë, veshur edhe nga një shtresë e trashë akulli, dergjek diku andej nga shkëmbinjtë e thepisur me dëborë. Ky do të ishte një riparim tepër i vësh-

tirë, që kërkonte mjaft ditë pune intensive, që kërkonte guxim e trimëri, që kërkonte vendosmëri dhe vetëmohim! Po, po, vetëmohim! Dhe dimri ishte tepër i egërsuar.

— Eh, c'lajm do t'u çojmë shokëve të Fierzës!
— tha Vangjeli.

Dhe u nisën përsëri në udhën e bardhë, të lodhshme, me plot të papritura. Ecën me vështirësi. Vonë, të lodhur e të dërrmuar nga udha e largët, mbërritën në atë luginë të thellë të Fierzës. Gjithshka ishte kredhur në errësirë.

Këta ishin udhëtarët e parë që kishin çarë atë rrugë të vështirë dhe gati të pakapërcyeshme. Dhe gjithkush i pa, u habit me ta. Si kishin mundur, si kishin guxuar të udhëtonin në një ditë të tillë?

U bë mbledhja e shtabit të hidrocentralit. Po atë natë, e ndofta në të njëjtën kohë, u bë edhe një mbledhje tjetër, po një mbledhje e jashtëzakonshme, e brigadës më të dalluar të hidrocentralit të Fierzës që mban emrin e Ismet Sali Bruçajt. Në një dhomë të gjerë mbushur plot me flamurë të kuq të punës, flamurë të garave socialiste, u mblohdën ata djelmosha të fortë, komunistë dhe të rinj. Ata ishin shumë. Iniciatorë për këtë mbledhje të papritur dhe të jashtëzakonshme atë natë të 27 janarit ishin komunistët e kësaj brigade.

— Fierza është pa dritë, bre burra! — tha një komunist më i moshuar. — A mundemi me qëndrue duerlidhur, kur lugina jonë ka heshtë?

— Jo! — u dëgjuan njëherësh disa zëra.

— Duhet më e gjetë na vetë difektin, — tha Hashimi, brigadier i trimave të kësaj brigade.

— Duhet me zgjedhë njerëzit më të fortë, që e durojnë të ftohtin, ata që janë lindur dhe rritur

në zonat më të ftohta të vendit tonë, — tha njëri prej tyre.

— Të gjithë duhet të nisemi në kërkim. Mos bëni dallime, — tha me një farë zemërimi një i moshuar.

— Jo, shok i dashur, jo. Kjo s'është e mundur! — ndërhyri me të shpejtë brigadieri. — Do të shkojë vetëm gjysma e brigadës, pra vetëm 50 vetë. Kaq mjaftojnë.

Pa mbaruar mirë brigadieri, befas në dhomë hynë disa shokë të shtabit të hidrocentralit, midis tyre edhe kryeinxhinieri. Ky i fundit dukej tepër i lodhur dhe i shqetësuar.

— A e dini pse kemi ardhur? — pyeti kryeinxhinieri.

— E marrim me mend, — tha brigadieri. — Një hall kemi të gjithë. A keni ardhë për dritën?

— Po, besa! Veçse teli është këputur në kampatën e Miliskajës. Në atë humnerë të mallëkuar është shumë vështirë të bëhet lidhja në këtë dimër të egër.

— E bëjmë ne! — u dëgjuan zëra.

«E bëjmë ne? Një fjalë goje!» Këtë shkoi ndër mend kryeinxhinieri, ndërsa po hetonte një nga një ato fytyra të ndriçuara nga drita e dobët e llambës. Padashur sytë i shkuan nëpër dhomë. Në një raft të vogël ishin vendosur disa vëllime të Veprave të shokut Enver. Më tutje, në një vend të dukshëm, ishte vendosur portreti i shokut Enver.

Pastaj kryeinxhinieri foli:

— Shtabi shprehu mendimin se dritën hidrocentralit mund t'ia risillni vetëm ju. Ne erdhëm të këshillohem me ju. Mund ta merrni një barrë të tillë?

— Po! — u dëgjuan zëra të vendosur.

— E bëjmë, e bëjmë! Ne do ta mposhtim dëborën e akullin. Po të jetë nevoja, ne do të sakrifikojmë edhe veten, vetëm që Fierza të ketë dritë.

Këtë ishin fjalët e anëtarëve të brigadës me brigadier Hashimin në krye. Sa mirë e njihte këtë brigadë kryeinshinieri! E kush nuk i njihte trimat e brigadës «Ismet Sali Bruçaj»? Ata erdhën të parët këtu në Fierzë, ata hodhën themelet e para të ndërtuesave, ata vendosën shtyllat e betonta 600 kilogramëshe nëpër majat e thepisura të Fierzës, të Bajram Currit, të Lekbibajt e të Iballës, duke i bartur mbi shpatulla, ata rrëzuan atë shpat mali në Poravë me lartësi 170 metra, me gjerësi 100 metra dhe thellësi 20 metra. Po, po, 66 mijë metra kub shkëmb e bënë njësh më tokën! E ku mund të përshkruhen heroizmat e kësaj brigade?

... Mëngjes i 28 janarit 1976. 50 guximtarët kishin hipur mbi dy makina. I printe një buldozer, që hapte rrugën nga dëbora e madhe. Në brez secili mbante nga një litar. Dëgjohej vetëm uturima e motorëve. Askush nuk fliste. Ishte ftohtë dhe acari të hynte gjer në palcë. Një makinë me dërrasa e karpentierë i ndiqte nga pas. Shtabi i hidrocentralit kishte parashikuar çdo gjë. Do të ndërtonin një kapanon për ata që do të kishin nevojë të ngroheshin, të rimerrnin forcat dhe të shmpinin gjymtyrët. Ata e dinin që do të kish vështirësi, prandaj u ruheshin të papriturave.

— E ç'na duhet ne kapanoni? — tha një ndër pjesëtarët e brigadës. — Pse, sa kujtojnë ata se do të qëndrojmë?

Ata e dinin se duhet të luftonin shpejt, që drita të vinte sa më parë në Fierzë.

Dëbora vazhdonte të binte. Në kilometrin e 24-t u ndalën. Këtu ishte Miliskaja, këtu do të zhvillohej beteja e rreptë. Po, këtu ishte fronti i luftës së tyre.

— Hajt, djema, zbrisni, se mbërritëm! — u tha brigadieri me një zë optimist.

Vendi vërtet ishte i thepisur. Dikush iu afroa qoshes së rrugës dhe, pasi vështroi atje poshtë, fërshëlleu nga habia.

— A jeni të fortë, burra? — iu drejtua dikush.

Ata e njobën atë. Ishte zëvendësministri i Ndërtimit.

— Të fortë si shkëmbi! — u përgjigj brigadieri.

— Hajt, ndizeni njëherë! — u tha ai.

Dhe ndezën nga një cigare.

Që të fillohej beteja, më parë duhej njobur «armiku», pra duhej hetuar me imtësi vendi, monopatet, çdo gjë.

— Na duhet të kalojmë në anën tjetër të humnerës, — tha brigadieri. — Duhet ta shohim prej andej këtë anë ku jemi.

Dhe ashtu bënë. Brigadieri priu. Pas tij shkuau edhe 10 vetë të tjerë. Me ta ndodhej edhe kryein-xhinieri. Çanin nëpër dëborën që u vinte deri në brez, ecnin nëpër një terren të panjohur, ecnin paditur se ku e vinin këmbën. Por nuk ndaleshin. Zbritja dhe ngjitja për në anën tjetër ishte e vështirë. Kaloi një orë e gjysmë. Merrnin frymë me vështirësi. Pastaj tërë vështrimet e tyre u përqëndruan matanë humnerës, atje ku kishin qenë më parë. Vendi ishte krejtësisht i thepisur. Si do të mund të zbrisnin atje? Dhe ata vështruan njëri-tjetrin, si për t'i blerë mendimet e secilit. Vetëm me litar mund të zbrisnin. Po, po, rrugë tjetër nuk

kish. Do të vareshin poshtë me litar dhe dikush nga lart do t'ua lëshonte litarin metër pas metri.

Prej atje ku ndodheshin caktuan disa pika ku do të qëndronte njëri dhe tjetri, ku do të bashkoheshin për të térhequr dy telat e rëndë të tensionit të lartë. Ishin dy tela që përshkonin këtë linjë.

— Nisemi për atje ku ishim! — u dha komanda. Dhe u nisën përséri. Duhej shpejtuar. Kthimi, me gjithëse ishte më i vështirë, duhej bërë më shpejt.

Myftari përdrodhi këmbën gjatë kësaj ngjitjeje të shpejtë. Dy e morën në krahë, por pas pak ai, duke mos dashur t'i lodhë më shumë shokët, u tha:

— Lërmëni, tani s'kam gjë.

Dhe ata i besuan. Por Myftari ecte me shumë vështirësi, me një sforcim të jashtëzakonshëm të energjive, të vullnetit. Këmba i ish enjtur, por ai nuk tregoi. Sepse kishte përpara një betejë, nga e cila s'kish ndër mend të ndahej për asnjë çast.

Kur arritën përséri te Shkëmbi i Miliskajës, pu shuan pak. Dikush nxori një shishe konjak dhe u dha të pinë nga pak. Tani ata e dinin se nuk duhej të prisnin më. Minutat ishin të shtrenjta për Fierzën.

Hashimi lidhi pas belit litarin.

— Zbrit tash! — foli një zë i sigurt.

Të tjerët mbanin fort skajin e litarit. Hashimi u buzëqeshi shokëve. Ai e dinte se zbriste i sigurt, sepse duar muskuloze do t'ia lëshonin pak nga pak litarin.

Menjëherë ndjeu ta shtërngojë litari. Do ta duronte dhembjen në bel, do ta duronte litarin, që tashmë i ngrinte duart, pasi ishte veshur krejtësisht nga një shtresë akulli. Nga shkëmbi i thepisur shkëputeshin herë pas here copa dëbore që e godis-

nin në fytyrë, në trup. Por ai zbriste dhe zbriste, me shpejtësi, me durim, me gjakftohtësi.

Si zuri vend, tundi litarin. Kjo donte të thosh se ai po bënte pakëz pushim. Pastaj, vetëm pas dy-tri minutash, litari përsëri u tund. Zbritja do të vazhdonte. Dhe duhej të zbriste në fillim 100 metra, pastaj 150, derisa të mbërrinte atje poshtë, në themëllësinë e 200 metrave.

— Hej, litar i mallëkuar, fryshtë po më merr!

— tha me zë brigadier Hashimi.

Më në fund zbriti poshtë. Nguli këmbët. U zgjidh dhe pastaj vendosi njérën këmbë në një vend të mirë për t'u mbështetur dhe lëvizni litarin. Litari u tërroq sipër me shpejtësi. Brigadieri e dinte se të tjerë do të bënin po atë rrugë që bëri edhe ai. Dhe ai i priste të vinin atje pranë tij. Frynte shumë ajo luginë e Miliskajës. Fytyra e brigadierit ishte skuqur. Nisi të lëvizte që të mos i ngrinin këmbët. Kjo ishte e domosdoshme të bëhej. Ndërkohë një tjetër po zbriste që nga sipër. Brigadieri ngriti sytë ta dallonte se cili ish. Po, po, e njohu, ishte kandidati i Partisë Myftari. Ai bënte stazhin e Partisë në një front shumë të nderuar të luftës për socialistin, në frontin e dritës. Dhe ja, këtu kishte ardhur të jepte shembullin personal. Sepse komunisti duhet të jetë gjithmonë i pari në sakrifica dhe i fundit në pretendime, sepse komunisti duhet të prijë kudo me shembullin e tij personal.

Njëri pas tjetrit zbritën edhe komunistët e tjerë të brigadës. Zbritën 20 vetë, 20 trima, 20 luftëtarë. E dukeshin këta si një grumbull shqiponjash në atë bardhësi të pafundme. Era ulërinte. Duart mezi i komandonin.

— Ndiej sikur këmba po më mpihet tha Myftari.

— Mbahu, he burrë, duro edhe pak.

E çmund t'i bënin shokët atje poshtë në atë humnerë? Dhe Myftari nuk e hapi më gojën. Tani do të nisnin të têrhiqnin kabllin. Njérën fije duhej ta têrhiqnin së bashku, në një kohë, me një komandë të vetme. Sepse kablli ishte tepër i rëndë, sepse rrëshqiste, dhe mezi mbahej nga shtresa e trashë e akullit që e kish veshur.

— Ho-o-op! Ho-o-o-p! Dhe zërat e tyre jehonin në atë luginë, ku përziheshin me zhurmën e erës që ulërinte me të madhe. Dy hapa ecnin përpara dhe pastaj pesha e rëndë e kabllit i têrhiqte prapta një hap. Se ishte një kabëll rrëth 450 metra i gjatë. E vështirë ishte kjo ecja përpara. Zegiri nuk i zotëronte më duart e tij. Ato thuajse kishin ngrirë.

— Si ta mbaj kabllin? — Po ta lëshonte dikush kjo do të reflektohej në punën e të tjerëve, litari d'o t'i têrhiqte mbrapsht atëherë. Shokët i kishin besuar atë pjesëzë të litarit, atë «front» për të mbajtur, dhe ai s'duhej të krijonte asnje të «çarë».

E vuri për një çast pjesën e vet të kabllit nën sqetull. Kjo ishte barrikada e tij, vallë duhet ta lëshonte atë, ta braktiste? Jo, në asnje mënyrë! Për një çast, kur e pa se e kishte vështirë të ecte përpara bashkë me telin, e mbajti atë me dhëmbë. Ndjeu t'i ngjiteshin buzët në kabllin e akullt dhe pas pak pikë gjaku nisën t'i rrjedhin prej tyre. I kish çarë ato. Po nuk bëri «oh», nuk kërkoi ndihmë. Me forcat e tij do ta mbante atë kabëll të mallëkuar, që po i shkaktonte aq dhembje. Uli kokën pak më poshtë, duke dashur me këtë lëvizje të lehtësonë sadopak peshën e rëndë të kabllit.

«Nuk duhet të dorëzohem, nuk duhet!» Si çekan i rrjdhënët në 'kokë këto fjalë.

— Po shokët, ç'bëjnë, vallë? Bëri disa hapa përpara. Si nëpër mjegull i vinin fjalët «Ho-o-op! Ho-o-o-p!» dhe si pa vëtëdije ecte përpara, i nxitur nga ato fjalë plot tingull, plot vendosmëri.

«Ecin shokët! Po dëgjoj ujin e përroit që rrjedh nën akull. Domethënë jemi afër fundit. Duhet të mbahem, se ndryshe u turpërova» i dha kurajo vetes. Nxori përséri duart nga xhepat dhe sikur pati një farë lehtësimi.

— Ho-o-op! Ho-o-p! — bashkoi edhe ai zërin me korin e ngjirur të këtyre guximtarëve të Miliskajës.

— Arritëm, **djema**, arritëm tek **pjesa** tjetër e kabllit! thirri brigadieri.

Këto fjalë i erdhën të largëta Zeqirit. Në anën tjetër kishin zbritur 20 trima të tjerë. Edhe ata kishin kaluar nëpër dëborë por më me pak vështirësi, pa u lidhur, sepse vendi nuk kish qenë aq i thepisur. Midis atyre që takuan atje poshtë ishte edhe Fejziu, mjeshtri i talentuar i lidhjeve të kabllove. Nuk ishte një lidhje e lehtë. Kishte sekretet e veta ajo: duhej përdorur ngjitja me kallaj e tubit ngjitet, duheshin bërë disa kthesa të kabllit, që lidhja të bëhej e fortë e pazgjidhshme, që t'i rezistonte çdo tufani dhe akulli. E kjo ngjitje duhej bërë në atë kohë të akullt, ku gishtat mezi lëviznin, kur era frynte me ashpërsi dhe egërsi. Por ata e mposhtën atë vështirësi. Pas një ore e gjysmë ngjitja qe bërë. Mjeshtri i talentuar kish bëre një punë të persosur dhe plot art. Ky ishte teli i parë që u ngjít. Tani duhej sjellë këtu poshtë edhe teli i dytë. Dhe ishte pikërisht ora 14.30. Trimat e Miliskajës e dinin se duhej të shpejtonin, se po të errej, beteja e tyre do

të dështonte. Prandaj nxitonin, prandaj duhej të bënин të pamundurën.

U sollën bukë para se të nisnin fazën e dytë të kësaj beteje: sallam, tërë të mirat si dhe konjak e verë për t'u ngrohur. Nofullat e ngrira mezi u lëviznin, ndërsa duart u dridheshin nga të ftohit. Nuk i zotëronin dot.

Pas dhjetë minutash nisi të tërhiqej kablloja që kishin ngjitur. Beqiri, elektricisti që kish ardhur nga Tirana, kish hipur në majë të shtyllës së hekurt dhe priste të bënte lidhjen atje lart. Dukej sikur era do ta rrëzonte për tokë Beqirin, por ai mbahej fort. Nuk duhej të dorëzohej. Ai e dinte detyrën e tij, sakrificën që duhej të bënte, derisa ky kabell i rëndë dhe i akullt të vihej në vendin e duhur. Beqiri nisi punën për sigurimin e kabllit. Trimat e tjerë, që ndodheshin poshtë, nisën tërheqjen e kabllit të dytë. Ishin tashmë 40 vetë. Një punë e dytë, që kërkonte po aq vështirësi sa e para. Por ata e dinin se nuk mund të tërhiqeshin. Fjalën ia kishin dhënë Partisë dhe atë s'mund ta bënин dysh, edhe sikur t'u kërkonte jetën. Fierza kërkonte dritë dhe një ditë pa punë i thoshnin miliona lekë të humbura. Jo, s'duhej asnjë ditë më tepër të heshtte Fierza e tyre!

Vetëm në orën 7 të mbrëmjes, pas 14 orë lufte me natyrën, me vështirësitë, ata bënë edhe lidhjen e telit të dytë. Dhe, u ngjiten lart, askush nuk u largua nga vendi. Prisnin me ankth. Vallë do të vinte drita?

— Alo, alo! Fushë-Arrëzi, Fushë-Arrëzi! u dëgjua një zë nëpërmjet radios. — Lëshoni korentin! Lëshoni korentin!

Kaluan disa çaste. Ishin tepër të vështira ato.

Fushë-Arrëzi s'po lëshonte akoma dritën. Por këto ishin vetëm disa çaste. Pas pak e tërë lugina e Fierzës u ndriçua. Dritat u shpërndanë kudo si yjet e zjarrta nëpër atë errësirë dhe ndriçuan sheshet, kantieret, ndërtesarat, ftyrat e qeshura të njerëzve.

— Urra! Urra, — shpërthyen të thirrurat paprimas atje në Miliskajë.

Ishin urratë e fitores së njerëzve tanë të mrekullueshëm, të edukuar nga Partia e shoku Enver. Ishin brohoritjet e atyre njerëzve që me guxim të rrallë, me shpirt të sakrificës, me vendosmëri të pashoqe kishin mposhtur çdo vështirësi. Drita elektrike shkoi përsëri në Fierzën gjigante.

NDËRGJEGJE PROLETARE

Kantieri i hidrocentralit të Fierzës nuk ka qëtësi. Edhe lumi Drin, herë-herë egërsohët. Copa të akullta lëvizin me shpejtësi mbi sipërfaqen e lumit plak. Zhurma monotone e Drinit duket sikur përhapet në tërë luginën e Fierzës, rrëthuar me kodra të larta, të thepisura e shkëmbore, mbuluar me dëborë. Pas pak u dëgjuan shpërthimet e minave atje, në galerinë e kërkimit, ku punonin minatorët e turnit të natës të brigadës së Hashimit, e cila mban emrin e Ismet Sali Bruçajt.

Minatorët numëruan me kujdes shpërthimet e forta që u shpërndanë me jehonë nëpër luginën e zbardhur nga dëbora dhe pastaj dolën nga vendet ku ishin fshehur.

— O burra, shokë! Të pastrojmë sa më parë galerinë nga materiali i rënë!

Vagoni i Ramizit dhe i Mehmetit u mbush me shpejtësi.

— Hajt, Ramiz, tash jepi, se s'pret puna!

Dy shokët u vunë në lëvizje. Dolën jashtë galerisë me vagonin plot e përplot. Ishte natë. Qielli sikur i paralajméronte guximtarët e galerive se së shpejti do të niste përsëri dëbora.

Vagoni u zbraz me zhurmë në lumë.

— Nxitojmë! — tha Ramizi.

Dhe të dy iu ngjitën së përpjetës për t'u futur përsëri në galeri dhe pér të hequr sa më parë materialin e rrëzuar nga minat. Bënë kështu disa rru-gë. Papandehur, në kohën kur po bëheshin gati të rrrokullisnin gurët në lumë, vagoni u përkul më shumë se zakonisht dhe, sa hap e mbyll sytë, u shpëtoi nga duart dhe u fundos në ujë.

— Kujdes! — jehoi zëri i fortë i Mehmetit.

Ata u tërroqën me kohë, sepse duke e shtyrë vagonin ishin gati të rrëzoheshin edhe vetë atje në lumin e akullt.

Vagonistët panë njëri-tjetrin në sy.

— Bo-bo! — ia priti Ramizi.

Në fytyrat e tyre të rrahura nga era dhe të skurra nga të ftohit u pasqyrua dëshpërimi. Që të dy vështruani vendin ku ra vagoni. Poshtë shinave të hekurta lumi e kishte gjerryer tokën dhe shinat nuk kishin mbajtur më, por ishin përkulur së bashku me peshën e vagonit të ngarkuar plot e përplot. Ishte në të zbardhur. Pas pak do të fillonte punën turni i ditës, kurse vagoni u qe zhytur në ujë.

— Hej, ç'po bëni, burra?

Vagonistët kthyen kokën menjëherë andej nga erdhi zëri.

Kishte ardhur brigadieri i tyre. Turni tjetër donte edhe një orë të fillonte punën.


«S'ka gjumë ky!» i shkoi nëpër mend Ramizit.

— Na ka rënë vagoni në lumë, — tha si i zënë në faj Mehmeti.

— Ashtu, ë? Po si u iku nga duart?

— Ishte natë, lumi e ka gjerryer tokën përpشتë shinave...

— Justifikime! Po planin si do ta realizojmë sipas jush?



725
72294

Dy shokët heshtën.

— Bukur, besa — ia pat Hashimi! Në thellësi të zemrës ai e ndiente se vagonistët i vriste ndërgjegjja, bile i erdhi keq që u foli në atë mënyrë këtyre dy vagonistëve të dalluar të brigadës. Sakaq brigadieri u largua. Të dy vagonistët kishin qëndruar si të ngrirë në vend.

— Ta nxjerrim nga lumi! — tha i vendosur Mehmeti.

— Po si? — pyeti me dyshim shoku i tij.

— Do të gjejmë një kavo, pastaj do të futemi në Drin, ta lidhim atë tek vagoni dhe pastaj me buldozer ta tërheqim.

— Po a kemi si futemi në këtë të ftohtë bre burrë?

— Ah, ftohtë! Po vagoni? Po turni që do të mbetet pa punë sa të sjellim vagon tjetër? — ia priti Mehmeti.

Kjo mjaftoi për Ramizin. Ai nuk u përgjigj më, por ia dha vravit në kërkim të kavos së çeliktë. Era frynte. Mehmeti padashur ngriti jakën e xhaketës së tij të mbushur me pambuk. Pastaj kjo iu duk fare e kotë. Ai tani do të fillonte të zhvishej për t'u hedhur në valët e Drinit. Ja edhe shoku i tij po vinte me vrap.

— E gjeta, për besë, kavon! — tha ai me gëzim.

— Zhvishemi!

— Njitash!

Dy vagonistët hoqën teshat e trupit dhe u bënë gati të hidheshin në Drin. Për një çast sikur ngurruan. Në trup ndien të ftohtin e akullit.

— Futemi! — ia pat Mehmeti.

Dhe që të dy u futën në ujë. U dëgjua një «oh!» e fortë. Një minator që kaloi andej pranë u

tmerrua. Ky ishte Latifi. Goja sikur iu muar, pastaj shpërtheu:

— Ehej, djema, ç'po bëni? U marrosët?

Dikush nxori kokën jashtë nga lumi. Por pastaj u zhyt me të shpejtë brenda. Latifi vrapoi të kërkonte brigadierin që t'i ndalonët këta kokëkrisur. Pas pak, bashkë me brigadierin erdhën edhe të tjerë minatorë.

Njëri nga vagonistët nxori kokën mbi sipërfaqjen e ujit. Pas tij edhe tjetri. Ky i fundit shtërngoi kavon në dorë e u zhyt përsëri ta lidhë tek rrota. Por s'po dilte. Shokët u shqetësuan. Me të shpejtë dy të tjerë u zhveshën dhe u futën në ujë të shpëtonin shokun, që menduan se ishte në rrezik. Sapo u zhytën ata, vagonisti doli mbi ujë dhe bërtiti:

— E lidha kavon!

Ky ishte Ramizi.

— Dil jashtë!

Pas tij dolën edhe të tjerët. Ata që ishin jashtë hoqën gozhupet e tyre dhe ua hodhën shokëve të lagur.

Ndezën shpejt e shpejt një zjarr, ndërsa një minator solli një shishe konjak.

— Na, pini dhe shpejt largohuni që këtej!

— Jo, nuk largohemi pa e tërhequr vagonin!

— Shkoni, shkoni — u tha brigadieri. — Ju punën tuaj e bëtë, tani e kemi lehtë ta tërheqim me buldozer.

Ramizi dhe Mehmeti iu bindën brigadierit. Të tjerët u vunë në lëvizje të nxirrin vagonin. Dy vagonistët diku larg kishin qëndruar. Nuk u ikej pa e parë vagonin të dilte nga lumi.

— Ja, e nxorën pér besë! — ia pat njëri. Dhe u larguan të gëzuar.

DASHURIA PËR SHOKUN

I pashë nga afër ata burra të fortë, të paepur, që luftojnë me aq guxim me shkëmbinjtë e malet atje, buzë Drinit plak, që tashmë e ka humbur një herë e përgjithmonë qetësinë e tij shekulllore. Vite të tëra kanë këta që punojnë mes malesh e luginash të thepisura, që rrëzojnë shkëmbinj të ashpër, që gjerryejnë tunele në bark të maleve. Dhe duken ata më të fuqishëm, më të patundur nga kjo natyrë e ashpër këtu në Fierzën — kantier, ku po ndërtohet vepra e madhe, e mrekullueshme e Partisë. Dashuria për këta njerëz të shtohet jo vetëm kur i sheh se si punojnë, se si hedhin betonin, se si mbajnë martelin, se si vendosin minat, se si hedhin në erë malin, por edhe kur qëndron me ta jashtë punës në rrugë, në mensë, në dhomat e tyre të gjera, plot ajér e dritë. Janë njerëz të thjeshtë, të urtë, gazzmorë, që qeshin me gjithë shpirt nga ndonjë shaka e shokut, që kënaqen pa masë nga tingujt optimistë të sharkisë ose të çiftelisë së minatorit nga fshati Nimç, që gjallërohen nga vallet e shkathëta e dinamike të malësisë së tyre. Ata e duan shumë njëri-tjetrin dhe është kjo një dashuri, e thjeshtë, pa bujë, e thellë dhe e fuqishme. Për shokun lënë ko-

kën. Kur ai është në rrezik shqetësohen dhe hidhen të parët për ta ndihmuar.

Tek po qëndronim në mensën e kantierit të tumeleve të ndërtesës së centralit, me disa minatorë gazmorë, një shok i veshur me një xhaketë të trashë pambuku, më thotë:

— Puna i afron njerëzit, i bashkon dhe i lidh me një miqësi të ngushtë dhe të pazgjidhshme. Dua të tregoj për dy shokë të ngushtë. Janë këtu në hidrocentral që nga fillimi i punimeve. Duke punuar atje në luginë, befas njërit i rrëshqet këmba dhe si një gur i rëndë, ra drejt e në ujet e ftohtë të lumit Drin. Valët e përpinë. Ai nuk po dilte në sipërfaqe. Koha nuk priste. Shoku ishte në rrezik. Dhe ishte ditë e ftohtë shkurti me ngrica, që edhe i veshur trashë të ishje, të hynte të ftohtit deri në palcë. Po shoku i mirë nuk merr asgjë parasysh kur është fjala për jetën e shokut. Dhe u hodh me të shpejt, pa asnje ngurrim, ashtu siç ish. Uji i akullt sikur ia mpiku gjymtyrët minatorit nga malësia, sikur ia shtrëngoi fort gjoksin, tamam sikur të ishte mbërthyer nga një darë e çeliktë. Ai e dinte se ky veprim ishte tepër i rrezikshëm, se mund ta pësonë edhe ai vetë, sepse Drini është i pamëshirshëm sidomos në këtë muaj të vitit. Lumi rridhte me tërsëllim e plot zhurmë. Kjo e pengonte minatorin të orientohej për të parë se ku gjendej shoku i zhytur në ujë. Dhe ja, ai pa një dorë mbi ujë, që lëvizti pa fuqi dhe u zhyt përsëri. Kjo e gjëzoi, prandaj i çau ato valë me një forcë të çuditshme dhe, kur ishte fare pranë tij, bëri një sforcim. U zhyt nën ujë dhe e mbërtheu shokun që ta nxirrte. E pati shumë të vështirë. Ishte një duel i egër dhe i pabarabartë me Drinin e tërbuar. Të nxjerësh nga lumi

në breg një njeri që ka humbur ndjenjat éshtë me të vërtetë e vështirë. Po çfarë nuk bën solidariteti punëtor! Minatori veteran gjeti në vetvete forca të mëdha dhe ja, pas disa minutash, ai, duke mbajtur shokun në krah, arriti deri në breg të lumit. Sapo doli, bërtiti me sa fuqi që kishte: «E-he-e-e-j! që ta dëgjonin shokët dhe t'i vinin në ndihmë. Me të dëgjuar thirrjen, shokët e tij vrapiuan me një frymë. Panë dy njerëz të pafuqishëm, të shtrirë, të lagur mu aty buzë lumit zemërak. I morën në krah që të dy dhe i futën në një vend të ngrohtë. U kujdesën përtëta me shumë dashuri dhe u qetësuani vetëm atëherë kur shoku që kishte rënë në lumë erdhi në vete. Sytë iu mbushën me lot gjëzimi. Shoku i tyre kishte shpëtuar.

Një ndodhi e papritur

Tunelet e ndërtësës së centralit hapen duke kapercyer shumë vështirësi. Herë pas here nga tavanet e tyre të larta bien copa gurësh, prandaj njerëzit punojnë atje me shumë kujdes, duke zbatuar me rigorositet të gjitha rregullat e sigurimit teknik.

Atë ditë janari të ftohtë armatorët po siguronin vendin përtu hapur front pune minatorëve. E ndërsa po punonin, befas ndodhi një shembje. Gurë shkëmborë nisën të bien nga tavani.

— Kujdes, shokë! Largohuni! — u dëgjua një zë i shqetësuar nga tuneli.

Brigada që po punonte atje brenda u nda në dysh: një pjesë në njérën anë dhe tjetra në anën tjetër të shembjes. Pastaj, midis asaj qetësie të për-

kohshme që u vendos, u dëgjua një zë i mbytur:
«Ndihmë sho-o-ok-ë-ë!»

Pra dikush ishte në rrezik. Ndjenja e shqetësimit si një rrymë elektrike përshkoi minatorët.

— Këtej, këtej! — bërtiti Mustafai, një minator me trup të paktë por të lidhur e të shkathët. Dhe ndërsa tha këto fjalë vetë çau përparrë.

Ai e dalloj menjëherë se nga vinte zëri. Pas tij vrapuan Muharremi, Maliqi, Neziri, inxhinier Xhemali, Myftari e shokë të tjerë. Vendi ku shkuan ata paraqiste akoma rrezik. Gurët, ndonëse më të vegjël, vazhdonin të binin nga tavani plot ujë i tunnelit. Edhe ata mund të rrezikoheshin, të aksidentoheshin, por kjo s'u vajti aspak në mendje, sepse një shok i tyre ishte në rrezik dhe u kish bërë thirrje për ndihmë.

— Ja ku është, ja! — thirri plot gëzim një minator kur pa gjeometër Kujtimin që ishte futur në një kanal të ndërtuar enkas për raste të tilla rreziku.

Sipër kanalit kishte rënë një masiv shkëmbi që e pengonte të dilte prej andej gjeometrin. Kujtimi ndjeu nga afir shokët që kishin ardhur për ta shpëtuar dhe moi kurajo.

— Levat, levat e hekurit! — dëgjoi ai një zë.

Njëmbëdljetë shokë u grumbulluan atje. Po kjo punë ishte e vështirë dhe me shumë rreziqe. Prandaj kjo kërkonte që ata të ishin të vëmendshëm, të saktë në lëvizje, të shpejtë.

Tërë tunel i progresivit 115 priste në ankth.

— Ho-o-o-o! Ho-o-o-o-p! — dëgjoheshin zërat.

Levat po e bëni punën. Shkëmbi lëvizi nga vendi.

— Edhe pak, edhe pak! Jepini, burra!

Dy gurë raë përsëri nga tavani. Njëri goditi

kasketën e një minatori, kurse tjetri nuk preku njëri. Më në fund shokun e nxorën. Guri i kishte shkaktuar disa plagë.

Makina e urgjencës e çoi me të shpejtë Kujtimin në spital. Në ditët që pasuan, shokët e vizitonin herë pas here atë. Dhe doktor Lefteri habitej me këtë dashuri të singertë, të heshtur të minatoreve për shokun e tyre. Ata nuk iu ndanë spitalit derisa Kujtimi u kthyte përsëri në gjirin e tyre.

* * *

Për këto ngjarje më folën minatorët e Fierzës. Ç'njerez të mrekullueshëm që janë ata! Duken të ashpër në pamjen e jashtme por po të qëndrosh me ta edhe pak kohë, do të zbulosh botën e tyre të brendshme të pasur, shpirtin e tyre të madh, çiltërinë dhe dashurinë e madhe që kanë për njëri-tjetrin, për njeriun e punës me të cilin ndajnë gëzimet e tyre, shqetësimet për veprën e madhe që ta mbajrojnë para afatit të caktuar; që drita e Partisë të ndriçojë anekënd atdheut tonë të bukur socialist.

PUNËTORE TË THJESHTË ME NDËRGJEGJE TË LARTË

Udhëtonim nga Fierza për në Shkodër. Që nga kabina e makinës vështroja natyrën e bukur, male të mbuluara me dëborë, përrenj që derdheshin me zhurmë, stalaktite me majë të mprehta, ndonjë bari të moshuar që nxiste delet dhe qingjat njomcakë të shpejtonin. Dhe ja pas pak edhe disa shkollarë. Dëbora vazhdonte të binte. Shkollarët ishin të veshur trashë, si për klimën e ashpër dhe të ftohtë të këtyre anëve. Nxitonin për në shkollën e tyre të Porravës. Një mësues, bashkë me nja tre vocrrakë, ecte nëpër dëborë.

— Hej, shoku mësues, a doni me hipë? — foli shoferi me të cilin udhëtoja.

Mësuesi ktheu kokën menjëherë andej nga i vinte zëri dhe, duke i hedhur një vështrim mirësjellës shoferit, i hypi vocrrakët në karroceri. S'kishim bërë as njëqind metra kur makina u ndal përsëri. Dy fëmijë të vegjël, të veshur trashë me xhaketa pambuku dhe kokore që u mbulonte edhe veshët, kishin nxjerrë dorën përpara. Ata nuk vështronin as majtas e as djathtas. Dukeshin si dy statuja të vogla anës rrugës.

— I shikon? — m'u drejtua shoferi. — As një fjalë nuk të thonë, vetëm dorën nxjerrin pérpara. Demek po deshe na merr, po s'deshe jo, — vazhdon shoferi.

Shoferi zbriti përsëri nga kabina dhe këmbët iu zhytën në dëborë.

— Hajdeni, kolopuçët e xhaxhit, hajdeni, — u tha dhe pastaj një nga një i hipit në karroceri.

Pas nja tri-katër kilometrash u ndalëm. Ja ku ishte shkolla e Poravës, atje poshtë. Tymi i zi që nxirrte oxhaku i madh i saj, binte në kontrast me atë çarçaf të bardhë që kishte mbuluar çatinë e shkollës së re të fshatit.

— Të falemnderës — u dëgjuan njëherësh disa zëra fëminore.

— Ju falë me shëndet — ia priti shoferi.

Tufa e fëmijëve u bashkua me grupin tjetër që po luante në oborrin e madh të shkollës. Kur ne po largoheshim, u dëgjua zilja e fillimit të orës së parë të mësimit.

— Kjo dita e sotme më kujton një rast që më tregoi disa ditë më parë një shofer, — theva hesh-tjen unë.

— Ashtu?

— Po, po, — vazhdova unë. — Ai ishte caktuar për tre muaj me radhë të ngarkonte dru që nga thellësitë e pyllit dhe t'i conte në stabilimentin e sharrave. Rruga i binte pranë një shkolle. Nxënësit e njihnin atë. E thërrisin xhaxhi Toma. Çdo mëngjes Toma i mblidhte si kokrra molle këta vocërrakë. Kjo natyrisht i hante ca kohë, se duhej të ndalte shpesh për të hipur vocërrakët në karrocë. Por një ditë e di ç'i ndodhi? Në asnjë vend nuk i pa vogëlushët. U mërzit, bile. Ku të jenë, vallë?

Ç'të ketë ndodhur? Ata shejtanë ishin marrë vesh njëri me tjetrin që të mos e lodhnin shoferin dhe të mos i harxhonin benzinën. Prandaj kishin vendosur të ngriheshin më herët e të grumbulloheshin të gjithë në një vend.

Shoferi u gëzua që i gjeti bashkë. Ishte mësuar me ta. Dhe kështu për tre muaj me radhë, që nga tetori e deri në dhjetor, ata e bënin rrugën bashkë. U miqësuan shumë me xha Tomën.

Ndërsa fliste, shoferi i drejtoi sytë anës rrugës, mbi një trung të madh ahu të copëtar. Gjurmët e prerjes ishin ende të freskëta.

— Hej, çfarë trungu! — thashë unë.

— Ra parmbërëmë nga pesha e akullit nëpër degët e tij të thata, — tha shoferi. Shikoi rrënjet sa të trasha i ka. E kanë prerë natën.

S'i dhashë rëndësi kësaj përgjigjeje, por shoferi vijoi:

— Ishte ora 11 e natës kur u ndodhëm përpara kësaj peme shekullore të rrëzuar.

— Hej, thashë. Po e kalokemi natën në déborë. Nuk kishte burrë që ta luante prej vendit atë. U strukëm në kabinë. Fillova të ndiej të ftohtin të më depërtojë nga këmbët. Kur befas dëgjoj zhurmën e motosekës të thyejë qetësinë e asaj nate të ftohtë me déborë. Ç'kishte ndodhur? Një nga sharrëxhinjtë kishte vrapuar në shtëpinë e shokut të tij.

«— Merr motosekën dhe hajde me mua», — i kish thënë.

«— Ç'ka asht, he burra, në këtë natë të ftohtë?»

«— Asht zanë rruga, nesër kanë me udhëtue makinat dhe s'ka kush u liron rrugën» — ishte përgjigjë tjetri.

Dhe ishin nisur në terrin e natës ata të dy

përmes dëborës dhe erës për një detyrë që s'ishte aspak e tyre, që u përkiste të tjerëve, punëtorëve të mirëmbajtjes së rrugëve.

— Kur erdhën pranë nesh, nuk i vumë re. Dritat i kishim fikur. Edhe ata s'deshën të na prishin gjumin. Prandaj kishin nisur punën vetë.

— Dhe i latë vetë? — pyeta.

— Jo besa! Dolëm edhe ne kur dëgjuam zhurmën e motosekës. Më bëri përshtypje puna e tyre. Të heshtur, kokulur, por shumë punëtorë. Pas pak u ktheva përsëri në kabinë të ndez prozhektorët e makinës. Vendi u ndriçua për bukuri. Pas dy orësh gjithshka kishte mbaruar. Trungu shekullor ishte prerë dhe larguar nga rruga.

«— Hajt, natën e mirë! — na thanë».

«— Ju lumshin duart! — u thamë. «Ç'njerëz të mrekullueshëm! mendova me vete.

— Po emrin a ua mësove? — pyeta unë.

— Kush, ata të flisnin? Jo, or jo, ishin tepër punëtorë e fjalëpakë.

I ishim afruar fshatit Mézi. Zhurma e motosekës dëgjohej përsëri diku larg.

— Ai duhet të jetë, — thashë. Dhe më erdhi shumë keq që s'kisha mundësi të zbrisja nga makinë, t'i ngjitesha atij monopati dhe t'i shtërgoja dorën atij sharrëxhiu të heshtur, që për mua u bë shumë i dashur. Megjithatë mendova: Le të hyjë në këtë shkrim si njeri pa emër, sepse njerëz të tillë të mrekullueshëm ka kudo.

NJEREZ TË HEKURT

Brigadieri i ndërtimit, Llambi, bashkë me disa shokë të tij, po udhëtonin për në Fier. Ishte ora 11 e mbrëmjes. Shokët e Llambit po dremisnin, kurse vetë ai kishte hedhur vështrimin përpara, andej nga dritat e autobusit çanin errësirën e natës. Shpatullat dhe krahët i dhembnin: kishin betonuar atë ditë estakadat. Betoni i kishte lodhur. Në plan e kishin që të shtronin asfalto-betonin për bazamentet, por makina, kushedi përsë, nuk kishte ardhur. E kishin pritur deri vonë. Dhe tani shkonin të flinin. Mirëpo papandehur Llambi vuri re në një kthesë, përpara një kodre, një makinë.

«Mos është makina e Skënderit me asfalto-beton? — tha me vete Llambi. — Po sikur të jetë ajo?».

Makina po afrohej. Tani dallohej më mirë. Po, ishte ajo. Si mund të shkonte Llambi në shtëpi e të flinte? Asfalto-betoni mund të shkonte dëm po të mos punohej atë natë.

«Duhet ndalur autobusi! Duhet ndalur sa nuk është vonë!» vendosi ai, që donte të kishte ndërgjegjen të qetë.

— O shofer, pa ndale, të lutem, autobusin!

— Pse, ç'ka ndodhur?

— Asgjë, vëllezër, por duhet të zbresin nja pesë a gjashtë shokë.

Llambi me shokë zbritën nga autobusi dhe hi-pën në makinën e asfalto-betonit.

Kur mbërritën në Ballsh njëri nga shokët i tha brigadierit:

— O Llambi, t'i thërrasim edhe shokët e tjerë të brigadës?

Brigada e tyre përbëhej nga 18 vetë. Midis tyre kish edhe mjaft të rinx. Llambit, që i erdhi keq t'i zgjonte ata, megjithëse e dinte se të nesërmen do ta qortonin, tha shkurt:

— Le të flenë! Mjaft jemi ne.

— Deri në orën tre të mëngjesit ata shtruan asfalto-betonin.

Të nesërmen ata filluan punën përsëri bashkë me të tjerët.

— Po këtë kush e shtroi? — pyeti njëri nga të rinxjtë e brigadës.

Brigadieri nuk foli, e as shokët e tij. Të tjerët panë njëri-tjetrin në sy.

Punën e 15 ditëve në 36 orë

Koleci bisedoi me Rushitin, kryetarin e komitetit profesional të montatorëve. U ishte vënë de-tyra të montonin sa më parë kolona me lartësi më se 35 metra dhe me gjërsëi afro 3 metra.

— Hë, si thua? E ngremë në 36 orë? — i ishte drejtuar brigadierit Rushiti.

— Unë them se po. Por duhet të bisedojmë edhe me montatorët e tjerë të brigadës.

— Dakord jam, — iu përgjigj Rushiti me entuziazëm.

Të dy ata mblodhën shokët e brigadës. Kishte edhe djem të rinj që akoma nuk kishin vënë bris-kun në faqe, si Fiqiriu, Sabiu, Petriti e shumë të tjerë, por që ecnin nën shembullin e më të mirëve, nën shembullin e komunistëve.

— E ngremë! — kishin thënë shokët e brigadës.

Pati disa jashtë brigadës që shprehën një farë mosbesimi, por shokët e brigadës, ia nisën punës. Ishte një ditë e nxehjtë, dielli të përvëlonte. 24 vetë nga montatorët duhej të punonin brenda kolonës metalike për të mbërthyer pajisjet e ndryshme të saj. Por atje temperatura ishte edhe më e lartë pér shkak të nxehjes së pllakave metalike.

Koleci e Rushiti jepnin shembullin personal. Askush nuk fliste. Gjithsecili bënte punën e tij, punonin me nerva të tendosura.

Çlodheshin me radhë. Erdhi nata edhe pastaj përsëri dita. Bashkë me montatorët punuan edhe kryeinxhinier Llambi dhe shefi i sektorit, Ymeri, si dhe shokët kinezë. 36 orë pa ndërprerje. Në fund e ngritën atë kolonë të madhe me anën e vinçit. Vetëm atëherë Koleci mori frymë lirisht.

Pas disa ditësh ata bënë edhe një mbrëmje ar-gëtimi. Montatorët dinë jo vetëm të punojnë mirë, por edhe të këndojnë e të kërcejnë bukur.

Shkëndija në mesnatë

Saldatorja komuniste, Fatmira, ishte zemëruar kur i kishin thënë se shoqet e saj mund të punonin vetëm në turnin e parë.

— Nuk është saldimi natën për ju gratë e vajzat. Ç'keni ju, punën tuaj e bëjmë ne burrat!

Ky ishte një qëndrim mospërfillës ndaj vajzave saldatore. Ç'ishin ato fjalë se s'ishte saldimi natën për to? Ky koncept duhej thyer një herë e përgjithmonë. Të këtij mendimi ishin edhe shokët e Partisë.

— Filloni të punoni edhe në turnin e dytë. Do të keni vështirësi, por do t'ju përkrahim, — u kishte thënë Hasani, sekretari i organizatës bazë të Partisë të montatorëve.

Montatoret dhe saldatoret e reja e kishin pritur këtë me kënaqësi. Atyre u qe besuar të saldonin një rezervuar.

— Hej, kujdes, mos rrëzoheni nga skelat! — i ngacmonte ndonjëri.

Netët e para puna nuk u eci aq mirë. Nga 36 metra që ishte plani për të salduar nuk bënë veçse 20.

Ah, moj Mira, ç'po bëjmë kështu, do të turpë-rohemi, — i tha zëvendësbrigadieres Shpresa.

— Prit, mos u ngut, normën do ta bëjmë.

Kishin vështirësi sidomos në saldimin vertikal. Këtë e vunë re mjeshrat saldatorë. Brigadieri, Demja, dhe specialisti i kategorisë së pestë, Fotoja, u vajtën pranë për t'i ndihmuar. Vajzat e reja i dëgjuan me vëmendje spjegimet e tyre si i mbanin ata pincat, sa lirshëm e pa kontraktim saldonin edhe natën etj.

— Puna është të mos nguteni e të mos deku-rajoheni, — u tha brigadieri.

Një ditë Shpresës i kishte vajtur në punë për ta parë babai i saj, Hyseni, që punon si pëmpist në sektorin e naftës.

— Mirë, punon mirë — i kishin thënë — ia ka marrë dorën edhe saldimit natën. Njëlloj si ne burrat. Është iniciatore për gjithshka.

Hysenit i kishte ardhur mirë nga kjo. Për herë të parë ndofta mendoi se profesioni që kishte zgjedhur e bija ishte aq i bukur, aq fisnik e tërheqës.

* * *

Kështu i pashë ata ndërtonjës dhe montatorë. I pashë tek ngriheshin atëherë kur dielli i korrikut sa po lëshonte rrezet e tij të arta mbi kodrat e Usojës e të Panahorit e t'ia nisnin punës mbi konstruksione metalike, mbi nulla e kolona. I pashë këta ndërtonjës montatorë tek punonin e pastaj tek linin punën të qeshur e të gëzuar, plot optimizëm.

MINATORËT E HESHTUR TË QYRSAQIT

Aqifi u hodhi një shikim plot respekt e dashuri shokëve të brigadës së tij. Sapo ishin kthyer nga turni. Ja tek qëndrojnë pranë krevatit të Hysniut dhe kërkojnë me këmbëngulje që ai t'ia marrë një këngë të vjetër kuksiane. Sa orë kishin punuar dhe luftuar atje në zemër të shkëmbinjve të Qyrsaquit? Sa metra tunel kishin përparuar? Shumë, e megjithatë as që duan t'ia dinë për lodhjen. Nga fytyrat e tyre të qeta nuk mund të dalloje aspak gjurmët e një dite të vrullshme dhe të vështirë.

«C'njerëz!» mendoi ai.

— Hajt, Hysni, mos e zgjat tash. A po ia thua një këngë? — iu lut një shok i tij.

— Po ti, Maliq, a je gati me e shoqnue? — iu drejtua atij Fetahu.

— Unë e kam lehtë, për besë. Qe ku e nxora fyellin. Po Hysniu a është gati?

Hysniu, këngëtar i talentuar i brigadës së minatorëve po buzëqeshte.

— Po në qoftë se nuk këndoja, doni të ma lini mua fajin, a? — qeshi ai.

— Kush tha, he burrë? Po ti po nuk qe në formë, siç bëjnë disa herë artistët, nuk po të lutem më. Nuk dua të na këndosh pa zemër.

Për një çast ata panë njëri-tjetrin dhe nuk folën. Hysniu i bëri shenjë me kokë Maliqit dhe ky ia nisi një melodie të hershme popullore.

Tingujt e saj u shpérndanë nëpër kapanon. Ato ishin magjepsës e të bënin për vete. Me ta u bashkuan dhe tingujt depértonjës të këngës së Hysniut. Fytyrat e minatorëve, që nuk po flinin, u çelën akoma më shumë. Ata i rrëmbeu melodia e këngës së lashtë. Kënga e Hysniut dhe melodia e fyellit të Maliqit harmonizoheshin aq mirë.

— He, të lumtë goja, or Hysni!

— Na e kënaqe zemrën!

Kështu e shprehëm entuziazmin dhe kënaqësinë e tyre minatorët. Ata nuk duartrokitën, veçse i panë me plot dashuri shokët e tyre minatorë.

— Tash do t'ju këndoja një tjetër, — foli mendueshmë Hysniu.

Kaq deshi Hysniu. Tash atë nuk e mban dot njéri — foli i gjëzuar Bajrami. — Jepja, he, ta lumsha! Dhe jehona e këngëve të tyre vazhdoi deri vonë. Pastaj minatorët ranë të flenë. Ndërsa ata i zuri gjumi, Aqifi, brigadieri i tyre, ende ishte zgjuar. Ai sillte ndër mend punën që kishin bërë. 9 muaj kishin kaluar që kur nisën gërmimet në tunelet e Qyrsaqt. 1500 metra linear shkëmb kishin gërmuar në turne gjatë kësaj kohe dhe çdo muaj nxirrin nga tunelet më tepër se 10 mijë metra kub shkëmb nga 4500 metra kub që ishte plani i tyre. Për 12 muaj rresht ata nuk e kishin lëshuar nga duart flamin tranzitor të kantierit.

Në kapanone ishte qetësi e plotë. Natën e thellë e thyente zhurma e sondave, që shponte shkëmbinjtë në thelli si dhe shiu i rrëmbyeshëm, i bezdissëm që kishte filluar prej shumë orësh.

Fytyra e Aqifit u ndriçua nga drita e fortë e vetëtimës.

Bubullima e fortë që u dëgjua pas pak, mbuloi të gjitha zhurmat e tjera të kantierit të Qyrsaqtit.

Befas dera e kapanonit u hap me vrull. Aqifi kujtoi se shkaktare për këtë ishte era, por jo, ishte gabuar. Ishte inxhinier Ismaili dhe Zisoja, përgjegjësi i kantierit.

— O Aqif, O Aqif? — thirri Ismaili.

— Urdhëro, shoku Ismail!

— Zgjuar qenke? — pyeti Ismaili.

— Po, zgjuar jam, pse ç'ka ka ndodh?

— Punën nuk e kemi aspak mirë, o Aqif. Nga kodra po rrëshqasin vazhdimisht gurë. Ka rrezik të prishet kapanoni dhe të dëmtohen kompresorët që janë vendosur atje.

— Vërtet? — u shqetësua Aqifi.

— Po, Aqif! Prandaj erdhëm, të të lutemi që të ngresh brigadën e të punojmë jashtë për të hequr gurët dhe baltën.

Aqifi e çmoi menjëherë situatën. Vetëm një ditë po të mos punonin kompresorët kishin humbje të madhe. Sepse nuk mund të çuhej asnjë copë shkëmb pa ajrin e komprimuar.

Aqifi e hodhi tutje batanijen dhe u drejtua nga shokët.

— Çohuni, djema! Zgjohuni, Shyqyri, Fetah! Hajt, të gjithë lëvizni nga vendi! Bajram, Enver, më shpejt!

Një nga një, sikur të ishin në gjendje alarmi, u ngritën minatorët nën kushtrimin më të parë. Ishin 30 vetë. 30 malësorë nga Kukësi. Ata çanë errësirën dhe u drejtuan nga ndërtesa e kompre-

sorëve për të mbrojtur pasurinë e popullit, për të luftuar me natyrën e egërsuar.

Shumë gurë dhe baltë kishte sjellë shiu nga kodrat e larta. Minatorët u zhytën nëpër baltë, vendosën trupat e tyre nën atë rrebesch shiu dhe nisën luftën.

— Kujdes, ruhuni nga gurët! — tha brigadieri.
— More, ti atje, s'po çan kokën fare për gurët!

Dritat e forta pranë ndërtësës së kapanonit ndriçonin këtë tablo të mrekullueshme dhe heroike punë, këtë betejë të vërtetë me natyrën dhe egërsinë e saj. Por njerëzit ishin më të fortë. Asgjë nuk lëkundte vendosmërinë, vullnetin dhe guximin e tyre.

Orët kalonin. Përpjekja vazhdonte. Ndaj të gdhi-rë shiu ishte pakësuar. Edhe vërshimi gjithashtu. Agimi i bardhë i ditës së re u dha dritë fytyrave të guximtarëve. Ato ishin serioze, të lodhura, por të gëzuara. Kishin fituar një betejë të ashpër.

Pranë Aqifit kaloi Hysniu. Ai çalonte nga këmba e djathët. Brigadieri e pa me habi.

— Po ti, ç'ke në këmbë?
— Jam plague pak. Më ra një gur.
— E pse nuk the gjë? Pse heshte?
— S'kisha kohë të mendoj për këmbën. Ishin në rrezik kompresorët.

— Dhe gjithë ato orë ashtu ke punuar? — unxe Aqifi. — Ta kisha ditë do të të kisha nisur menjëherë në kapanon.

— E unë bash për atë punë heshta.
— E tash shko në infermieri. Më duket se të paska rrjedhë shumë gjak.

Hysniu u largua duke çaluar. Pranë minatorëve të tjerë u afrua inxhinier Ismaili.

— Ju falënderoj me gjithë zemër, o shokë.

— Pse na falënderoni, inxhinier? Ne bëmë punën tonë, — u përgjigj në emër të shokëve Aqifi.

Ismaili nuk pati q'të thoshte më dhe, si u mendua pak, shtoi:

— Tani gjumë të rehatshëm!

— Jo, pér besë, pa e ba tectorëshin në tunel nuk fusim këmbë në kapanon! — foli me vendosmëri Xhemali. — Si thoni, ju shokë?

— Xhemali ka të drejtë. Në tunel, shokë! — thanë të tjerët.

Fytyra e Ismailit mori një pamje serioze, në grykë iu mbështuall një lëmsh. Ai u prek thellë nga kjo shfaqje tjetër e ndërgjegjes së lartë të minatorrëve.

Nuk kaloi shumë dhe brigada u mblodh përsëri në vendin e punës së tyre të përditshme. Si çdo ditë, edhe sot brigada bëri apelin.

— Ismet Sali Bruçaj! — lexoi Aqifi emrin e anëtarit të brigadës së tyre.

— Ismeti ka rënë në krye të detyrës, — u përgjigj në vend të mësuesit hero Mustafai.

Të tridhjetë burrat kuksianë u përgjigjën në apel. Kjo ceremoni, që organizonin çdo ditë, nuk ishte aspak e kotë. Akti heroik i mësuesit Ismet Sali Bruçaj ishte bërë pér ta një burim i pashtershëm frymëzimi. Çdo ditë ata plotësojnë normën e mësuesit hero, që tanimë konsiderohet anëtar i brigadës së tyre. Dhe e nisën punën në tunel.

Kur po dilnin nga tuneli, edhe Aqifi mbante në duar martelin. Ndonëse është zgjedhur brigadier, asnjëherë nuk e lëshon nga dora armën e punës. Ai punon njëlloj si të tjerët, në tunel, në thyerjen e shkëmbinjve, në transportim dhe kudo. Ai bile ka

marrë zotim të bëjë 500 norma pune në vit. Me këtë dhe ka fituar simpatinë e të gjithëve në Qyrsaq, atje ku ndërtohet hidrocentrali «Mao Ce Dun».

Mbi Qyrsaq ra mbrëmja. Një mbrëmje e bukur, pa re. Ishte pragu i festës së 1 Majit.

— A s'po na e merr një këngë, o Hysni? — foli Aqifi. — Apo s'mundesh, se të dhemb këmba?

— Jo, këmbën e kam më mirë, bile tash do të këndoij edhe më me qejf. Unë nuk mundem me ia prishë kurre brigadierit.

Dhe përsëri u dëgjuat kënga e Hysniut dhe melodja e Maliqit. Fyell dhe çifteli. Këta njerëz të mrekullueshëm suallën në kantier jo vetëm shpirtin e punës e të sakrificës, por edhe këngët, vallet e meloditë e tyre të bukura.

HERONJTË E FRONTIT TË ZJARRE

Ata njerëz të thjeshtë me fytyra të broncta, të kalitur në netët e ftohta gjatë ndërtimit të kombinatit metalurgjik dhe në ditët e vrullshme të betonimit, ishin mbledhur në një sallë të madhe dhe dëgjonin tek fliste sekretari i organizatës të Partisë të uzinës së koxsit, Mustafai.

Mbledhja ishte e jashtëzakonshme. Në të merrnin pjesë komunistë dhe punonjës pa parti, punëtorë teknikë, inxhinierë. Kishin ardhur të merrnin udhëzime për një betejë të fortë, një betejë të zjarrtë, që kërkonte vendosmëri të pashoqe, trimëri dhe heroizëm. Ata duhej të shembnin furrat e përkohshme të uzinës së koxsit. Atje temperatura ishte tepër e lartë — 1000 gradë celsius. Heqja e çdo tulle kërkonte kujdes të madh, shpejtësi, durim. Do të visheshin me mjete speciale, por, megjithëkëtë duhej punuar me sakrificë, në kushte shumë të vështira pranë portave të zjarra.

— Ne e dimë se të gjithë ju keni dalë vullnetarë për t'u ndeshur me vështirësi të mëdha. Ka midis jush që na janë lutur të marrin pjesë në këtë betejë — nisi të flasë zëvendëssekretari i organizatës bazë të Partisë, Përparimi, një djalosh i ri, trupedhur e muskuloz, me fytyrë të nxirë nga dielli dhe

të rrahur nga era, dhe, padashur, hodhi shikimin në sallë, për të shquar Mehmetin, që ndonëse shëndetlig, kishte dalë vullnetar që të punonte për të shembur dhe pastruar furrat e përkohshme të baterisë së koksit; ai pa Vladimirin, edhe ky komunist, i cili kur kishte marrë vesh se nuk ishte në listën e njerezve të «betejës së zjarrtë», ishte lutur që të mos e ndanim nga shokët e tjerë. — Për vështirësitet duhet të flasim qysh tani — vijoi Pérparimi, — duhet t'i njohim mirë ato, të masim forcat dhe mundësitetë tona, se ashtu do t'i përballojmë. Së pari duhet të dini se do të punoni në temperaturë shumë të lartë, gati të padurueshme. Pastaj do të keni lodhje fizike shumë të madhe; në këmbët tuaja do të kalojnë tubacionet e gazoilit të furrave dhe mjafton të ndodhë një çarje, sado e vogël, për shkak të përplasjes së tullave të skuqura, që të shpërthejë flaka. Por këtë, natyrisht, nuk do ta lejojmë, apo jo, shokë?

— Në asnje mënyrë, — u dëgjuan zëra nga salla.

— Nga ana tjetër kujdes me tullat e skuqura që do të hiqen! Ato mund t'ju rrezikojnë dhe të shkaktojnë djegie — nisi përsëri të fliste Pérparimi. — Por kryesorja që kërkohet nga ne është shpejtësia e manovrimit. Ç'dua të them me këtë? Një furre e përkohshme duhet të prishet brenda 30 minutave dhe ne kemi 58 të tillë. Po kaloi kjo kohë, atëherë tërë puna na shkon kot, temperatura e mureve të përhershme të baterisë së koksit, do të bjerë, dhe atëherë betejën e kemi të humbur, sepse nuk do të mund të prodhojmë dot koksin.

— Koksin do ta prodhojmë, se s'bën! — tha një komunist nga salla.

Pérparimi e njihte atë. Ishte Guri, brigadier i

rimontit të nxehjtë të baterive të koksit dhe kryetar i komitetit profesional të uzinës së koksit, Zëra të tjerë miratimi e shoqëruan Gurin. Tërë këta njerëz, afro 140 punëtorë të dalluar, komunistë dhe pa parti, do të luftonin për 36 orë, afati maksimal, për të shembur furrat e zjarrta të përkohshme për të vënë portën e hekurt në secilën furre, për të bërë që koxsi ynë, koxsi shqiptar, ky ushqim i domosdoshëm i furrnaltës dhe i furrave të tjera të shkrirjes, të prodhohej nga njerëzit tanë të mrekullueshëm, të edukuar dhe të kalitur nga Partia e shoku Enver.

Do të punonin në skuadra prej gjaشتë vetash, me afat vetëm prej pesë minutash, duke zëvendësuar skuadra skuadrën gjatë një turni pér tetë orë rresht. Secili punëtor do t'i afrohej temperaturës 1000 gradë 32 herë, do të punonte pranë asaj nxehtësie të pazakontë.

Beteja e zjarrtë nisi natën e së shtunës. Ishte ora 23.00. Nderi i takoi brigadës së Albertit, që punon në uzinën e çelikut. Frynte erë e ftohtë jashtë. Gumëzhinin nxehësit me gazoil të furrave. Shokët e brigadierit, Albertit, ishin veshur me rroba të bardha zjarrduruese. Ngjanin si njerëz të jashtëzakonshëm me ato rroba të trasha, me ato këpucë speciale me gomë poshtë, me doreza, syza të errëta dhe kapele mbrojtëse.

Iu afroan furrës së parë. Alberti ndjeu menjëherë nxehtinë përvëluese që dilte nga furra. Franë kishte edhe pesë shokë të tjerë.

— Fillojmë, Besnik? — iu drejtua ai shokut të tij.

— Po, brigadier! — u përgjigj ai pas disa çastesh.

Bulëza djerse mbushën fytyrat e tyre.

— Jepini, djema! — tha brigadieri — dhe ndjeu sa vështirë e kishin.

Nisën goditjet me leva. Duhej të shkëpusnin një-rën tullë nga tjetra dhe pastaj ta tërhiqnin me pirunj, capinj, ose gërryesa. Ishin pajisur me rreth 24 lloj veglash. Këtë lloj pune e bënин për herë të parë.

— Mirë, Besnik, tërhiqe tanë tullën!

Pranë këmbëve të tyre ndodheshin disa copa tulla refraktare të skuqura nga nxehësia, që bënin kontrast në atë sfond të errët.

— Kujdes, shokë! Do t'i hedhim poshtë! — tha njëri prej tyre.

Dhe hodhën poshtë disa tulla të tillë të zjarrita, që lëshonin xixa verbuese. Një copë dërrasë që u ndodh diku në një qoshe, sapo ra në kontakt me tullën, mori flakë.

— Mjaft, Albert, mjaft, kaluan pesë minuta!

Por askush s'lëvizi nga vendi. Urdhri u përsërit për së dyti dhe gjashtëshja e parë u bind të linte frontin e punës për t'u zëvëndësuar nga të tjerët.

U duk brigada e Gurit. Pjesëtarët e saj e nisën punën me «Urra!» Pikerisht si në sulm, si në betejë. Ja ku ishte edhe Perikliu midis tyre. E sa i kishte folë brigadieri Perikliut që të mos vinte, sepse ai ishte i sémurë me ulçer në stomak!

— Kot e ke, — i kishte thënë ai. — Nuk ndahem nga shokët. Të bëhet ç'të bëhet! Vështirësitet duhet t'i ndajmë së bashku.

Dhe Perikliu, si komunist që ish, nuk iu nda brigadierit. Ishin 12 vetë, pra gjashtë vetë më pak se të tjerët, por që duhej të realizonin prishjen e furrës brenda kohës së caktuar. Por ata ishin të fortë dhe të vendosur. Midis tyre ishin Lutfiu, Sadiku etj.

Punëtorët punonin me gjallëri me lëvizje të sigurta, të studjuara, të shpejta, me durim, gjakftohësi dhe vendosmëri. Ja të tillë njerëz të mrekullueshmë ka edukuar Partia. E ata janë fjalëpakë, nuk u pëlqen aspak të lavdërohen për heroizmin dhe guximin e tyre.

Askush nuk fjeti atë natë. Pas turnit të parë të natës erdhën forcat e freskëta të brigadës së kovaçhanes së uzinës mekanike të drejtuar nga Shaqiri. Forca të freskëta, tamam si në luftë, kur duhet dhënë goditja vendimtare për të fituar.

Kështu kaluan orët njëra pas tjetrës. Njëri turn u zëvendësua nga tjetri. Dhe erdhi përsëri mbrëmja. Shumë furra ishin shembur dhe në hyrjet e tyre ishin vendosur porta hekuri. 29 prej tyre ishin gadi. Në to mund të hidhej pluhuri i qymyrgurit për t'u bërë koks. Një mekanizëm i madh lëvizi në tërë platformën e gjerë dhe të gjatë dhe në secilën grykë, në intervale të ndryshme kohe, lëshohej sasia e duhur e pluhurit të qymyrgurit. Nisi kështu pra ai proces aq i pritur i koksifikimit. Në anën tjetër të baterisë vazhdonte shembja e furrave të tjera. Ishin çaste tepër emocionante për të gjithë. Si do të zhvillohej, vallë, ky proces? Kur do të dilte koksi nga portat e hekurta të furrave?

Projektorët ndrisnin sheshin e madh para uzinës. Koha erdhi. Mekanizma speciale shtyjnë koksin jashtë, copat e zjarrita të të cilat bien pa rregull mbi makinën e shuarjes. Pastaj makina me koksin e zjarrtë lëviz nëpër shina deri tek kulla e ftohjes, ku uji që bie në formë dushi e ftoh koksin.

Në ato çaste shpërthyen duartrokitjet, thirrjet spontane. Njerëzit nisën të përqafohen, sytë u mbushën me lot gëzimi. Pastaj midis asaj turme jehoi

fuqishëm parulla «Parti, Enver, jemi gadi kurdo-herë!».

Njerëzit tanë të mrekullueshëm kishin fituar edhe një betejë tjetër. Ata prodhuan koksin e parë në vendin tonë, lëndën që i jep frymëmarrjen e fuqishme metalurgjikut gjigant.

TE VENDOSUR TE THYEJNE ÇDO BLLOKADE

Ai i zbriti më me shpejësi ato shkallë, sikur të mos e pengonte fare ajo këmbë, që herë pas here i dhimbte. Kur e kishin pyetur nëse mund ta bënte modelin e bllokut të cilindrave, ai, pa hezituar, ishte përgjigjur: «Po, mund të bëhet».

Dhe tani mendonte për këtë përgjigje që kishte dhënë. Mos vallë ishte nxituar? Ai e dinte se prapa fjalës «po» fshiheshin shumë vështirësi, shumë të panjohura dhe të papritura, net pa gjumë, shqetësime të vazhdueshme, por e dinte edhe më mirë se të thuash «jo» do të thotë të ngresh duart lart para bllokadës imperialisto-revisioniste. Atëkohë sapo kishte marrë fletën për në shtëpinë e pushimit në Podgradec. Desh ta dorëzonte atë, por kur e morën vesh i thanë:

— Shko pusho, pastaj eja. Këmba jote ka nevojë për pushim.

U nis, por mendjen e kish tek ajo detyrë e rëndësishme. Herë-herë veçohej nga të tjerët. Dukej i menduar, shoku i tij i dhomës i kishte thënë:

— More, të shoh shumë të shqetësuar. Çfarë ke?

— S'më rrihet fare këtu. Partia më ka ngarkuar një detyrë të rëndësishme dhe unë vij e pushoj! Hajde, mendje, hajde!

Dhe e la pushimin përgjysmë. Në shtëpi nuk u çuditën kur e panë të kthehet pa e mbaruar lejen. E njihnin natyrën e tij.

— Tani, grua, zëre se nuk më ke në shtëpi për disa muaj.

— Mirë, mirë, mos kij merak. Vetëm ti puno i qetë, — i kish thënë e shoqja.

Duheshin bërë skicat më parë. Në uzinën «Enver» u takua me Abdullain dhe Gëzimin. Së bashku do të bënин skicat për bllokun e ardhshëm të cilindrave. Deri vonë bisedonin, diskutonin. Orët fluturonin shumë shpejt, aq sa as që i ndienin si i knin ashtu. Punonin deri vonë. Në skicat duhej zbërthyer çdo detal, duhej parashikuar çdo gjë në hollësitetë më të vogla. Modeli nuk ishte gjë e thjeshtë. Furnizuesve të huaj u ish këruar me valutë ky model, por ata kishin refuzuar, sepse kështu forconin më shumë bllokadën ndaj vendit tonë. Krijonin vështirësi të rëja. Dhe këtë e dinin fare mirë Saliu, Abdullai, Gëzimi. Ndaj natën e bënин ditë. Ata punonin me besim në forcat e tyre. Tek dokumentet e Partisë dhe fjalimet e shokut Enver gjenin burimin e frymëzimit, të guximit dhe të vendosmërisë për të çarë përpara.

Skicat u bënë gadi. Saliu e shokët e tij duhej t'i kthenin në pjesëza prej druni, që të marra së bashku do të krijonin modelin prej druri të bllokut të cilindrit. Por më parë duhej përcaktuar teknologjia e formimit dhe e prodhimit të modelit. Kjo kërkonte net të tjera pa gjumë.

Në repartin e modeleve u ndez biseda:

— Ne e dimë se do të keni vështirësi! Por ndërtimi i modelit do të jetë një sukses i madh për ne dhe një grusht i fortë për revolucionistët.

Saliu i vështronte me dashuri ato fytyra të ndezura, të vendosura të punëtorëve. Ishte i sigurt se me këta punëtorë të rinj do të kalonte çdo vështirësi.

U krijua grupi i punës. Një i ri 22-vjeçar iu afrua Saliut.

— Po mua, mjeshtër, nuk do të më fusësh në këtë grup?

Saliu e vështroi me simpati atë djalosh.

— Përse kërkon të futesh në këtë grup? — e pyeti Saliu.

— Aspak për lavdi. Dua që me grushtet tuaja të bashkoj edhe unë timin për të thyer bllokadën e egër imperialisto-revizioniste.

Saliu e harroi fare dhembjen e këmbës. S'kish kohë të mendonte për të. Si mjeshtër që ish, nisi të punojë edhe vetë. Në shtëpi nuk e zinte vendi. Sa herë kish qëlluar të çohej pas mesit të natës dhe të sulej drejt e në uzinën «Traktori». Modeli i ri ishte shkaku i shqetësimeve të tij, i lodhjeve, por edhe djemtë e rinj nisën të ndjekin shembullin e mjeshtrit. Shumë i vendosur në punë tregohej Edmondi. Orë të tëra nuk luante fare nga vendi. Vetëm duart i lëviznin dhe sytë i ndrisnin nga një gëzim i brendshëm. Ishin 42 copë forma, që duheshin punuar në dru, që duheshin skalitur me daltë.

Kishin kaluar disa muaj. Kaloi vjeshta e artë, dhe erdhi dhjetori i ftohtë, me shi e me ngrica. Punë e lodhje, gëzim e shqetësim.

Dhe ja, më në fund çasti përfundimtar! Punëtorët revolucionarë e preqatitën modelin shumë të koklavitur dy muaj para zotimit që kishin marrë. Tani mjeshtër të tjerë të talentuar do të merreshin me preqatitjen e formave, me derdhjen.

Inxhinieri teknolog Theodhori, dhe teknologu Thimi ishin preqatitur prej kohësh për këtë derdhje. Ata e dinin se puna që do të bënин ishte shumë e vështirë. Blloku i cilindrit ishte me përmisa të mëdha, me formë gjeometrike të komplikuar, muratura e bllokut ishte e kufizuar me një seksion mesatar 6-7 milimetra, gjë që vështirëson mbushjen e tij. Nga ana tjetër duhej të përcaktohej me saktësi receptura e përzierjes formuese, raportet e elementeve përbërëse të saj si për zemrën ashtu edhe për format. Kérkohej pra një punë e saktë shkencore. Nga ana tjetër duhej të përcaktohej përbërja e përshtatshme e gizës, të formulohej ngarkesa metalike: sa gizë verxhine, sa rikupero, sa çelik. Duhej të përcaktohej temperatura e shkrirjes së gizës, koha e derdhjes së saj në forma etj. Kjo ishte një punë tjetër, që kërkonte eksperiencë dhë shqetësim.

Zografi, një punëtor duarartë, me ndërgjegje të lartë, tanë kish punën më me përgjegjësi: do të preqatiste format për derdhje. Si gjithnjë i qetë, i matur, i kujdesshëm, ai i bëri njërin pas tjetrës 42 forma për të 42 pjesët e bllokut të cilindrit.

Dhe erdhi çasti i fundit. Në repartin e fonderisë kish shumë njerëz. Midis tyre edhe kureshtarë nga repartet e tjera. Shqetësim dhe emocion kishin të gjithë. Aty ishte edhe Saliu. E ku do të futeshin tërë ato forma njëra pas tjetrës! Ishin futur 41 forma. E 42-ta kish mbetur akoma jashtë.

«Po kjo, ku do të futet? Sikur s'ka më vend»!
shqetësohej Saliu.

— Mos u shqetëso! — i tha dikush Saliut.

Ky buzëqeshi. Tani çdo gjë varej nga Jakupi. Si do ta realizonte ai derdhjen? Giza ish gati:

— Kujdes! — u dëgjua një zë.

Pas pak ajo masë e lëngshme dhe e zjarrtë u derdh dhe, sa hap e mbyll sytë, sikur u përpi brenda atyre zgavrave e kthinave të pafund të bllokut të cilindrit. Vetëm avuj të nxeh të dolën nga brenda. Duhej pritur tre orë e gjysmë derisa të ftohej metali i lëngshëm dhe të merrte trajtën e ngurtë. Kur u hap forma, ishte i pranishëm edhe drejtori i uzinës «Traktori». Një miting i vërtetë. Blloku i cilindrit ishte derdhur pér mrekulli. Sytë e njerëzve shkëlqenin nga gëzimi. Ky ishte një sukses i mrekullueshëm i njerëzve tanë që, të edukuar nga Partia, çajnë përpara dhe shpartallojnë çdo bllokadë. Kjo ishte një dhuratë e bukur në fillim të vitit të 35-vjetorit të themelimit të Partisë.

Drejtori i uzinës iu drejtua Saliut, që kish qëndruar mënjanë:

— E, mo Sali, pa eja këtu! Të lumtë, dhe tani ik në shtëpi e çlodhu pak!

— Mirë, shoku drejtor, — u përgjigj Saliu me sy të përlotur.

Ai ndiente një gëzim të papërshkrueshëm pér fitoren që kishin arritur.

As të nesërmend e as në ditët që pasuan Saliu, ky njeri i thjeshtë e kokulur, i palodhur, novator i dalluar, nuk qëndroi në shtëpi. Uzina ishte e shtrenjtë pér të, asnje ditë nuk mund të qëndronte larg saj.

KJO NDODHI NË LLADOMERICË

Atë mbrëmje bënte ftohtë në Lladomericën kufitare. Bora që kishte rënë në mëngjes ishte ngjeshur mirë pas tokës së bërë kallkan. Ftohtë ndienin edhe shoferët, që kishin zbritur nga automjetet e tyre atje në të dalë të fshatit.

— Sa orë keni që po qëndroni këtu? — pyeti një shofer që sapo erdhë.

— Përse pyet? — iu drejtua atij një shofer tjetër.

— E kam fjalën sa kohë keni humbur duke pritur të hapet rruga, — vijoi shoferi i parë...

— Aha, ja si qenka puna! — u përgjigj sakaq shoferi i dytë.

— Do të qëndrojmë gjatë kështu, — tha me një farë zemërimi shoferi i parë.

— Se mos e dimë ne? Shohim e bëjmë, — u përgjigj me një ton pak si të vrazhdë ai që me sa duket ishte përgjegjësi i asaj autokolone makinash.

Në fytyrat e njerëzve të udhëve të largëta pas-qyroheshin shenjat e pakënaqësisë dhe të hidhërimit njëkohësisht.

— Po si ngece, ore derëbardhë, mu në këtë vend të rrezikshëm? Si nuk i mëshove edhe më gazit sa ta kaloje atë të shkretë të përpjetë?

— Se mos e pata në dorë! Rrëshqitën rrotat, — u mundua të shfaqësohej shoferi i makinës.

Shoferët e panë ftohtë shkaktarin e bllokimit të rrugës. Ç'kishte ndodhur? Makina e ngarkuar me pupulit kishte rrëshqitur në një vend tepër të rrezikshëm, buzë humnerës, njëra rrotë qëndronte ngrihet në ajër. Që nga kabina e shoferit dukej humnera e zezë, që s'i dukej fundi. Kështu, më këtë ak-sident krejtësisht të paparashikuar ishte ndërprerë trafiku që nga Ostreni i Madh e deri në Klenjë. Në këtë mënyrë asnjë makinë nuk mund të shkonte në zonat e dëmtuara nga tërmeti në rrëthin e Dibrës, asnjë makinë nuk mund të rikthehej për t'u ri-ngarkuar me materiale në pika të ndryshme.

Ajo makinë që qëndronte më një këmbë «buzë varrit» duhej shpëtuar me çdo kusht. Në ç'mënyrë? Duhej një traktor që të mund ta tërhoqte më shumë kujdes. Po ku ta gjeje në këtë kohë dëbore? Diku shumë larg prej këtu, traktorët po e bënin punën e tyre duke hapur rrugët nga kjo pengesë e bardhë, e ftohtë dhe e pamëshirshme. Një shok, që kishte ardhur pranë shoferëve, u tha se traktori mund të vinte vetëm të nesërmen. Pra duhej të prisnin deri sa të kalonte kjo natë e ftohtë dimri dhe të zbardhë dita tjetër. Mërzia pasqyrohej qartë te secili shofer.

Bënte ftohtë. Ata njerëz të udhëve të largëta e plot zik-zake filluan të ndiejnë se si i ftohti gjithnjë e më shumë po u depërtonte në trup duke e bërë të paduruar qëndrimin jashtë.

— Futuni në makina! — u dëgjua një zë urdhëronjës. Me sa duket ishte përgjegjësi i autokolonës.

Por askush nuk lëvizi. Shoferët panë njëri-tjetrin në sy. Si mund të futeshin në kabina kur duhej

të bënин diçka pér të hapur rrugë? Po si, në g'më-nyrë?

Nuk ish e lehtë të merrnin një vendim. Ai du-hej peshuar mirë.

— Mirë makinat e rënda nuk kalojnë dot, por duhet bërë diçka pér më të lehtat, pér katertonëshet, — vazhdoi shoferi.

— Ore, mirë thuq ti, — iu përgjigj aty pér aty një tjetër.

Dhe njerëzit u vunë në lëvizje. Dikush mori një lopatë, një tjetër kazmën dhe pas pak në anë të rrugës u dëgjuan kërcitjet e para të kazmave dhe të lopatave. Më vonë me ta u bashkuan dhe një grup fshatarësh dibranë, që u erdhën në ndihmë.

Punëtorë e fshatarë u gjendën pranë njëri-tjetrit. Në mendjet e tyre endej i njëjti shqetësim: të lirohej sa më parë rruga. Punohej pa pushim. Një palë zëvendësohej nga pala tjetër, që ritmi i punës të mos ulej pér asnjë çast. Një masë e madhe dheu ishte lëvizur. Makinat me tonazh të paktë tani mund të lëviznin. Dhe vërtet, ato kaluan në anën e kundërt të rrugës, kurse makinat me tonazh të rëndë s'kalonin dot.

Në atë kohë pranë grupit të shoferëve afrohet një tjetër shofer më kokën lidhur me një fasho të bardhë. Siç duket do të ishte aksidentuar gjatë këtij aksioni të madh pér zhdukjen e pasojave të tërmëtit. Ishte zeshkan, me një palë mustaqe të dendura. E quanin Sinan. Ai iu afrua kamionit që ishte buzë humnerës pa folur. Vështroi humnerën, vështroi rrot-tën që ishte varur në ajër. «Gjendja qenka me të vërtetë e vështirë», dukej sikur thoshte shikimi i tij i përqëndruar, dhe pastaj papritmas foli:

— Këtu ka një rrugë zgjidhjeje.

Të gjithë e vështruan me habi atë njeri, që foll, siç duket, pa u matur. E si mund të hiqej kamioni në këtë vend të vështirë dhe pa traktor? A ishte në vete ky shofer mendjemadh?

— Ç'thua, more, kështu? A e kupton se kjo makinë s'mund të lëvizë veçse me traktor? S'ka traktor, atëherë le të presim! — tha me zemërim një shofer.

— Jo, nuk duhet të presim më! — tha prerazi shoferi me kokë të lidhur.

— Pa dale ta dëgjojmë një herë mendimin e tij. Mos t'ia presim kështu me sëpatë, — ndërhyri një shofer me trup të bëshëm. Thuaje, more vëlla, mendimin, nuk të ndalon njeri ta shprehësh.

Sinani buzëqeshi nën mustaqe. Dritat e kamionave që ishin ndezur ia ndriçonin mirë fytyrën e tij energjike.

— E shikoni atë trung arre në anën tjetër të rrugës? — pyeti ai.

Të gjithë sa ishin aty kthyen kokën andej nga thoshte shoferi i porsaardhur. Pastaj vazhdoi:

— Dy makina me tonazh të lehtë, të cilat kaluan përpara, do të vendosen njëra pas tjetrës. Kavon e çelikut, pasi ta kemi lidhur tek kamioni buzë greminës, do ta kalojmë në trupin e arrës dhe që andej skajin tjetër do ta lidhim në njérën makinë, ndërsa me një kavo tjetër do të lidhet me makinën e dytë. Lëvizja e menjëhershme dhe forca e dy motorëve do ta lëvizin patjetër kamionin e rëndë. Ja, këtë mendoj unë. Rrugë tjetër nuk ka në këtë gjendje. Dhe, në qoftë se jeni dakord me këtë plan, atëherë të fillojhmë ta zbatojmë menjëherë, sepse koha nuk pret. Kolona e automjeteve të bllokuar po zgjatet pa mbarim.

— Mua më pëlqen kjo ide. Nuk është e keqe.

Ka mundësi të realizohet, — tha oficeri i trafikut Iljazi, që edhe ai ndodhej prej kohësh aty.

Shoferët heshtën. Pastaj brigadieri i brigadës së shoferave të kësaj linje, ndërhyri:

— Shokë, kjo është e pamundur të bëhet. Është punë me rrezik. Makina është e parkut tonë dhe unë përgjigjem në qoftë se ajo bie në humnerë. Janë miliona lekë, more vëllezër. Unë për veten time nuk jam dakord.

Ndërhyrja e brigadierit sikur i lëkundi njerëzit, të cilët kishin filluar të anonin nga shoferi guximtar.

— E përse nuk e lëmë këtë punë për nesër? Tani është natë dhe manovrimi është tepër i vësh-tirë, — u dëgjua një zë.

— Për errësirën mos u shqetësoni, vëllezër — ndërhyri me të shpejtë Sinani. — Ja ku i kemi dy makinat e tjera. Dritat e tyre do të na ndriçojnë krejtësisht vendin. Po nuk është fjala këtu. E dini se ç'do të thotë të presim deri nesër? Tërë makinat do të blokohen nga motorat. Dhe hajt pastaj ndizi të nesërmen, kur uji ka ngrirë.

Njerëzit mendoheshin. Ata sillnin ndër mend familjet që kishin mbetur pa strehë dhe që këtë natë do ta kalonin nëpër çadra. Ata duheshin futur një orë e më parë në shtëpitë e reja që po ua ndërtonte shteti.

— Shokë, unë e përkrah mendimin e Sinanit — ndërhyri një shofer.

— Le ta provojmë — shtoi oficeri i trafikut, Iljazi. — Kush ka kavo të gjatë?

Me të shpejtë lidhën kavon pas kamionit buzë humnerës dhe pastaj qëndruan. Kush do të guxonë tani të hipte në kabinën e kamionit? Ai që do të manovronte me timonin në kabinë do ta kishte pu-

nën shumë të vështirë. Rrezikonte kokën, sepse po të këpuntej kavoja nga sforcimi, dhe rastet nuk janë të rralla, atëherë përfundimi ishte i qartë: vdekje e sigurt.

— Kush do të hipë në timon? — pyeti si me drojtje Iljazi.

Shoferi i kamionit që ndodhej buzë humnerës preferoi të heshtte. Sinani e pa me vërejtje atë. Ky i fundit i uli sytë në tokë. «Ka frikë», mendoi më vete Sinani. Dhe, për të mos e zgjatur këtë pauzë jo të pëlqyeshme, tha me zë të qetë, por të vendosur:

— Në kabinë do të futem unë. Sepse unë dhashë mendimin. Prandaj unë dua ta provoj se sa i drejtë është ai.

Shoferi i makinës buzë humnerës ngriti kokën të vështrojë Sinanin. Shikimet e tyre u kryqëzuan. Sinani hipi në kabinë gjakftohtë dhe me një lëvizje të shpejtë. Ai rregulloi për një çast fashon më të cilën kish lidhur kokën dhe, pasi nxori kokën jaشتë kabinës, tha:

— Gati, shokë!

Oficer Iljazi i ra bilbilit. Kjo ishte shenja e lëvizjes së dy makinave të para. Fshatarët dhe shoferët e tjerë u larguan nga vendi i ngjarjes për t'i ruajtur çdo të papritura.

Makinat uturinin me zhurmë të madhe. Kamioni buzë humnerës bëri disa tundje në vend, por megjithatë nuk lëvizi asnjë centimetër përpara.

— Jepini edhe pak! Edhe pak, shokë! — tha Sinani.

Kamioni s'luante. Rrota e dytë e kamionit, që ishte anës rrugës, pengohej në disa gurë.

— Ndaloje makinën! Nuk e lënë gurët të lëvizë, — tha Iljazi. Kush vjen me mua t'i heqim?

— Unë, — tha brigadieri që deri atëherë kishte heshtur.

Projektorët e gazeve ndriçuan më shumë atë vend nën rrotën e makinës. Iljazi dhe Feridi me kujdes zgjatën duart e ngrira afër gurëve. Nervat i kishin të tendosura. Duhej gjakftohtësi. Dhe atë e kishin ata. Feridi kishte bërë një luftë me veten kur kundërshtoi që të bëhej kjo provë, por pastaj e kuptoi se ai si brigadier duhej të ishte në krye të detyrës, bile edhe të rrezikohej po të që nevoja, por makinën duhej ta hiqte nga ai vend i rrezikshëm.

Ja, një gur u hoq dhe plot zhurmë u rrokullis atje poshtë. Tani mbetej edhe guri i dytë, më i rrezikshëm. Asnjeri nuk fliste. Të gjithë sa ishin atje prisnin plot ankth dhe shqetësim. Më në fund guri u hoq. Vetëm në këtë çast njerëzit filluan të lëviznin të lehtësuar nga ai ankth shqetësimi që i kish pushuar.

— Gati? — U dëgjua përsëri fishkëllima e bilbilit të Iljazit, që çau ajrin e ftohtë të asaj mbrëmjeje dhjetori. Makinat nişën të uturinë përsëri. Tymi i motorave mbushi ambientin duke krijuar një velo të hollë, transparente dhe të hirtë. Diçka kërciti.

— Edhe pak! Edhe pak! — u dëgjuan zëra.

Kamioni luajti nga vendi dhe pas pak rrota që qëndronte pezull në ajër preku më në fund tokën e ngrirë.

— Urra! Urra-a-a! — ushtuan brohoritjet e gëzueshme të shoferëve.

Pesë kilometra të vështira në rrugën plot kthesa iu desh Sinanit të ecte me makinën mbraptazi. Atje pranë urës zbriti nga makina. Njerëzit dhe shoferët që erdhën pas tij zbritën nga makinat t'i shtërgonin dorën atij guximtari. Rruga Ostren i Madh — Klenjë tashmë ishte hapur.

M E T A L U R G U

Bakiu e rrotulloi nëpër duar atë detal dhe u vrenjt në fytyrë. Ai e kuptoi se për të pastruar këtë ingranazh duhej të harxhohej tjetër kohë. Këto pa-pastërti duhej t'i evitonte formisti, po të ishte më i vëmendshëm.

— Kush i ka derdhur këto detale? — pyeti.

Brigadier Zijai hodhi sytë nga mjeshtri i shkrir-jes dhe tha qetë:

— Aliu!

Mjeshtri i shkrirjes eci mendueshëm nëpër repartin e fonderisë së uzinës «Traktori». Kaloi pranë Aliut, atij formisti truplidhur e flokëzi. Me një lopatë në duar ky po hidhte me të shpejtë dheun e zi në një kasë metalike, në të cilën do të bëhej pas pak derdhja e detalit. E pa se si hipi sipër kasës dhe nisi të ngjeshë mirë me këmbë dheun. Pas pak, në repart, bashkë me zhurmat e tjera, u dëgjua edhe marteli i Aliut, që shtypte dheun në mënyrë ritmike dhe me shpejtësi.

Ishte i shpejtë në punë, por cilësisë nuk i jepte shumë rëndësi.

Bakiu po i hetonte që pas shpinës së tij lëvizjet e formistikët. Aliu as që e kish vënë re se atij i që afruar «baba». Kështu e thërrisin mjeshtrin e

shkrirjes metalurgët, me gjithëse Bakiu është ende i ri. E thërrisin kështu, sepse është shumë i afërt, i dashur dhe i kujdeshëm për se cilin metalurg të repartit. E jo vetëm për ta. Njerëzit e duan Bakiu për çiltërsinë e tij, për fjalët e ngrohta dhe thjeshtësinë e madhe.

«Përse ngutet, xhanëm? Kush e nxiton? mendonte me vete Bakiu — Pastaj edhe mungesat i ka shtuar. Dy javët e fundit kishte bërë vetëm dhjetë ditë-punë. Ku shkon kështu? Me se merret?» Këto mendime i vertiteshin në kokë Bakut tek vështronë Aliun duke punuar.

Pastaj Bakiu i doli përpëra formistik. Ky i fundit, sa e pa, e përshëndeti mjeshtrin e tij me plot dashamirësi. Po për çudi, vuri re që Bakiu ishte i vrenjtur në fytyrë. Qëndruan për një çast të heshur që të dy, pastaj Bakiu e theu heshtjen:

— Nxitohesh, vëlla, nxitohesh. Nuk bën kështu, jo!

Aliu i vrenjti vetullat, pastaj ngriti supet. Nuk po kuptonte ku e kish fjalën mjeshtri i tij. Bakiu, për të mos e lënë më gjatë në hamendje formistin e ri, tha përsëri:

— I ke parë detalet që janë derdhur sipas formave të tua?

«Aha, për detalet e mia e paska fjalën! E ç'kanë ato?» mendoi me vete, por mjeshtrit i tha:

— Si jo!

— Dhe të duken të mira?

Aliu heshti. E kuptoi se nuk duhej të fliste më gjatë. Me sa duket edhe këtë radhë e kishte shkelur, përderisa mjeshtri kishte ardhur posaçërisht tek ai. Por si t'i përgjigjej?

— Mua m'u dukën se dolën të cilësisë së mirë.

— Po, po, të cilësisë së mirë. Pa hajde t'i shikojmë bashkë.

Aliu i shkoi mbrapa me përtesë mjeshtrit të shkrirjes.

Bakiu u përkul në një grumbull detalesh të derdhura në gizë dhe, pasi ia afroi në fytyrë formistit, shfryu:

— Të cilësisë së mirë the! Pa shihi një herë! A s'e sheh sa kohë duhet harxhuar për t'i pastruar këto detalet e tua? Dhe kjo do të thotë që tjetri të humbasë kohën kot. A nuk e mendon se kush dëmtohet në këtë mes? Uzina, shokët e tu. Si thua, e drejtë është kjo?

Aliu heshtि për një çast. Këto fjalë të mjeshtrit sikur e fshikulluan me forcë në fytyrë dhe ai ndjeu një afsh të nxeh të t'i hipte dhe të kuqtë t'ia mbulonte fytyrën. C'përgjigje t'i jepte atij? Po, pa menduar më gjatë, tha:

— Epo mirë, or «babë», mos m'i paguaj këto detale. Ja, kollaj zgjidhet puna.

Bakiu u inatos.

— Bah, kështu thua ë? Bravo! Të bukur zgjidhje gjete! S'është puna aty, more Ali, jo! Puna është që ti ta kuptosh mirë se duhet të jesh më i kujdeshshëm. Të hapësh sytë. Ja, këtu është tërë puna. A e kuption se cilësia është mbi të gjitha?

Bakiu heshtि. I hodhi sytë Aliut. Piste. C'do të thosh, vallë, ai? Por, me sa duket, ai s'kish ndër mend të fliste, prandaj ndërhyri përsëri:

— Hë, pse hesht? Fol! Ke për të thënë gjë?

— E ç'të them? Ke të drejtë, «babë».

— Aha, paskam të drejtë, mirë. Por... pa na thuaj tani, pse mungove pesë ditë në punë në këtë dyjavësh? A nuk e di se kështu na pengon planin?

— Planin?! — u çudit Aliu. — Pö unë atë e kam realizuar, «babë». Ja, pyet po të duash!

— Brenda dhjetë ditëve, këtë do të thuash, ë?

— Pö, — tha më zë të ulët Aliu, si i zënë në faj, se e dinte ku do ta hidhët fjalën mjeshtri i tij.

— Dhjetë ditë punë, pesë ditë pushim. Dhe pastaj «ia shkel gazit» për të kapur kohën e humbur. Kurse për cilësinë, «punë e mëdhe». Kështu mendon ti, ë?

Gjatë bisedës ishin afruar edhe dy formisë të tjera. Njéri nga ata e thumboi rëndë:

— Eshtë i fejuar, ai «babë». Eshtë harruar pas gocës. I pëlqejnë më shumë shëtitjet nëpër bulevard.

— Të shetisë nuk e ndalon njeri, por amë puna eshtë punë.

Aliu e vështroi shtrembër shokun që fولي. Bakiu nuk desh që biseda të zgjatej më shumë. U largua. E dinte se më atë djale të ri, akoma të paformuar me cilësitë e mira të klasës punëtore, duhej të punonte akoma. Telashe të tjera do të kish. Dhe vërtet ashtu ndodhi. Punonte Aliu pesë-gjashtë orë dhe pastaj «fësht» se ku zhdukej. Më s'e shihte njeri në repart. Dhe këtë e përsëriti herë pas here.

— Ç'ta mbajmë në repart një njeri të tillë? Po na turpëron e po nà ul nderin e brigadës. Ta heqim qafe! — i kish thënë një nga punëtorët me shumë këmbëngulje.

Mjeshtër Bakiu nuk ia vinte veshin këtij e ndonjë tjetri si ky, që jepnin «mendime» të tillë. E thintri disa herë Aliun, në zyrë, e këshilloi, por më kot.

— E, more Baki, ç'e zgjat kot me të? Nuk të thamë ne që eshtë «koçkë» e fortë?

Po mjeshtri nuk jepte asnje përgjigje. Ai e dinte shumë mirë se për të formuar njeriun me tipare të

shëndosha nuk është punë e lehtë. Dhe vendosi t'i shkontë në shtëpi Aliut. Mori me vete edhe Vasilin, kryetarin e komitetit profesional të turnit «A», Hodon, sekretarin e organizatës së rinisë të turnit dhe Zijain, brigadierin e Aliut.

Formisti u skuq në fytyrë kur i pa shokët e uzinës t'i vinin edhe në shtëpi. «Po këta? Edhe këtu s'po më ndahan?», mendonte me vete.

Në shtëpi u ndodh edhe vëllai i tij më i madh. U duk sikur Aliu u turpërua, bile dha edhe fjalën se do të ndryshonte këtej e tutje. Por premtimin e mbajti vetëm për disa ditë.

«Të bëjmë mbledhjen e organizatës profesionale», thanë një ditë disa shokë. Por Bakiu qetësish ua mbushi mendjen:

— Nuk bën të përdorim të gjitha format menjëherë. Le t'i lëmë kohë të mendohet. Edhe mbledhje do të bëjmë, por më vonë, të presim edhe ca.

Një ditë mjeshtri iu afrua furrës së zjarrtë. Atë çast poçi i dytë po mbushej me lëngun e kuq.

— Ule edhe pak poçin, ule! — i tha Bakiu vinçieres.

Për çudi, vinçi as ulej, as ngrihej. Ç"po ndodhë? Mjeshtri iu ngjit me të shpejtë shkallëve metalike që të çonin lart në kabinën ku ndodhej vinçierja. Ishte bllokuar çelësi fundor. U munduan së bashku me vinçieren ta zhbllokojnë, por më kot. Gjendja ishte kritike. Duhej zhbllokuar me çdo kusht vinçi.

Aliu e kishte lënë mënjanë martelin e tij dhe po vështronë. Ç"do të bënte «baba»? Si do të dilte nga situata? Çeliku mund të ngurosej në poç. S'duhej lejuar që çeliku të humbte kot së koti. Aliu shtangu në vend kur pa mjeshtrin të zbresë nëpër kavon e çeliktë mu aty pranë poçit me lëngun e zjarrtë.

Atje ishte një temperaturë e lartë, me të vërtetë e padurueshme. Afshi i nxeh të përvëlonte. Bakiu vendosi këmbët tek buzët e poçit metalik. Aliu ngriu në vend.

«Mos luajti mendsh, «baba»? Bëhet shaka me çelikun e zjarrtë?», mendoi.

Të gjithë sa ishin në repart kishin ngrirë me shikimet e tyre lart, atje ku manovronte me shpejtësi mjeshtri i tyre i çelikut. Kavoja e çelikut kishte mbetur në një ganxhë. Kavoja, kavoja duhej çliruar. Bakiu u mundua ta heqë, por e kishte të vësh-tirë. Një afsh i nxeh të ia përshkoi trupin Bakut. Bëri edhe një sforcim të fundit dhe ja, kavoja u çlirua. Atëherë ai tundi kavon dhe bërtiti:

— Ule vinçin!

Por ndodhi një gabim. Vinçi përkundrazi u ngrit lart.

— Ndale! — klithi me sa fuqi kishte mjeshtri.

Katër gishtat e dorës së tij të djathtë i ishin zënë ndërmjet makarasë dhe kavos së çeliktë. Ai duhej të çlirohej nga kjo gjendje e rrezikshme. Atëherë u hodhën tërë punëtorët të térheqin me duar kavon dhe të çlironjë gishtat e mjeshtrit. Edhe Aliu nuk ngurroi aspak. I mbërtheu gishtat e tij të fortë në kavon e çelniktë dhe nisi ta térheqë nga vetja.

Bakiu zbriti poshtë duke shtrembëuar fytyrën nga dhembja e madhe. Pëllëmbën e dorës nuk e ndiente. Kur e dërguan tek mjeku, ky i fundit i dha dy muaj pushim. Por Bakiu raportin nuk ia paraqiti njeriut. Kërkoi t'i jepej leja e zakonshme. Ia dhanë menjëherë. Kur u kthye nga shtëpia e pushimit të punëtorëve ku kaloi lejen, u paraqit përsëri në punë.

— Ti ke edhe një muaj e gjysmë pushim. — i tha kryetari i repartit të fonderisë.

— Nuk qëndroj dot në shtëpi. Dorën e kam më mirë, — tha Bakiu.

Qëlloj që pranë tyre ishte edhe Aliu. Ai u habit. Lejen e zakonshme vjetore e përdori në vend të rapportit dhe tani kërkon të punojë kur e ka dorën akoma të sëmurë?

Kjo i bëri përshtypje të thellë Aliut. Ai e pamë respekt mjeshtrin dhe pastaj mendoi «Çfarë njeriu është ky, xhanëm?» Iu kujtua edhe një rast tjetër kur një punëtor kishte grisur pa u vënë re nga njeri raportin që i kish dhënë mjeku. Këto raste e bënë të mendojë gjatë Aliun.

«Po unë ku jam? A u ngjaj sadopak këtyre njerëzve?».

Nga mendimet e zgjoi zëri i qetë dhe i ëmbël i Bakut.

— Ali, do të vish sot të shkojmë bashkë në punë vullnetare?

Formisti i ri, padashur, hodhi sytë nga dora e mjeshtrit. Mund t'i lëvizte tani gishtat? Kështu dukej sikur thosh pamja e fytyrës së tij. Pastaj sikur e përshkoi një valë e nxehjtë nga brenda dhe tha:

— Do të vij, «babë». — Në zërin e tij dukeshin nota të gëzuara.

Rrugës i tregoi mjeshtrit për një gabim të ri që kishte bërë. Ai herë pas here fshihte një detal të mirë, që e përdorte vetëm ai për forma. Ishte një detal me «leverdi» si i thonë». E bënte këtë për të fituar sa më shumë, sepse me këtë detal paguhej më shumë.

Bakiu e vështroi me habi, por edhe më dhimbje njëkohësisht.

— Pse kështu?

Djaloshi uli sytë i turpëruar.

— Po unë nuk ta thashë kot, «babë». Këtë e them se e kam ndier gabimin. Askush nuk di gjë pér të. Unë vetë fola i pari.

Bakiu nuk u përgjigj. Po, ai e kuptonte se kjo ishte një gjë e mirë. Aliut kishte nisë t'i fliste ndërgjegjja.

Të dy së bashku punuan deri vonë në ndërtesën me punë vullnetare. Të nesërmen në repart u vendos një fletëlufttarake. Midis atyre që dallohen ishte edhe emri i Aliut, formistit të ri, dikur i «pandreqshëm».

Në repart Bakiu kryqëzoi shikimin me atë të Aliut. Ky i uli sytë pér tokë. Mjeshtër Bakiu e vëشتroi me dashuri. E kuptoi se tek Aliu kishte nisë ajo kthesë pér të cilën ai aq shumë ish përpjekur e kish luftuar.

RRUGA E NJË TORNITOREJE

Xha Stefi u çudit me mendimin që i kish lindur vajzës së tij 17-vjeçare për t'u bërë tornitore. Dhe ku pa, në uzinën mekanike, ku ishin tërë burra! Nikoleta qeshte me këto mendime të të jatit. Po ai e donte shumë të bijën dhe ajo ishte e bindur në fund të fundit se ai do ta miratonte mendimin e saj. Dhe nuk u gabua.

Nikoleta dhë Donika ishin të parat vajza që shkuan për të punuar në uzinën mekanike të Korce-s. Vajtja e tyre ngjalli një farë kurioziteti. Vështrimet e punëtorëve i ndiqnin në çdo hap.

Ato ishin dy vajza ndërmjet 25 djemve të repartit mekanik.

Që në ditët e para të punës Nikoleta ndjeu ngrohtësinë e gatishmërinë e shokëve për t'i ndihmuar.

Përgjegjësi i repartit, Agroni, një komunist i vjetër, i qëndronte afër për t'i mësuar sekretet e profesionit. I dha në fillim një torno të vjetër. Le të mësohej me atë njëherë. Mjeshtër Abedini e morri vetë përsipër ta ndihmonte atë vajzë me sy të shndritshëm, të gjallë. Shpesh shkonte tek ajo.

— Hë, si shkon puna? — e pyeste.

— Siç e shikon!

Ngathtësia dhe pasiguria me kohë filluan t'i kalojnë. Kur diçka nuk i shkonte mirë, qëndronte edhe jashtë kohës së punës. Kishte një këmbëngulje të

çuditshme. Ndonjëri nga shokët i afrohej pranë. «Ta bëj unë?» i thoshte. Nikoleta kundërshtonte duke vënë buzën në gaz. «Ç'njerez të mirë janë këta!» mendonte. Kur mbaronin punën katër a pesë tornitorë do t'i prisnin e do t'i përcillnin për në shtëpi dy shoqet. I donin si motra të tyre të vogla. Dhe kur shkonin në punë, dikush do t'u dilte përpara. Kështu Nikoleta dhe Donika e ndienin veten më të sigurta, në punë e kudo. Njohja e parë me punën u dha kënaqësi dhe gjëzim.

Në aksion

Nikoleta i hyri mirë punës. Asaj i besonin të bënte akse për pompat e ujit, bokulla. Mjeshtri gjëzohej: «Ç'vajzë e shkathët!» u thoshte shpesh të tjerëve.

Në zgjedhjet e reja e propozuan për anëtare të komitetit profesional. I dhanë sektorin e kulturës dhe shpejt ajo organizoi grupin e estradës, u bë pjesëtare e grupit artistik të uzinës. Por një ditë...

Kërkoheshin vullnetarë nga klasa punëtore për të shkuar një vit në fshat. Ndër të parët ngriti dorën Nikoleta. Pastaj Donika, Minella, Stavri, Minai. S'deshën tornitorët t'u iknin vajzat. «Shkojmë ne, ato të qëndrojnë!. kish thënë një tornitor si me drojtje.

— Nuk jam dakord me shokun — e kish kundërshtuar Nikoleta.

Punëtori i turpëruar uli kokën. Iku e qeshur Nikoleta. Duart plot kallo shtërgonin dorën e saj me dashuri.

— Viti ikën shpejt, djema, — desh t'i qetësonte ata shokë që i donte si vëllezër.

Moglica! Këtu do të punonte Nikoleta. Ishte një fshat malor me një pejzash të bukur. Atë dhe Donikën e vendosën në shtëpinë e xha Llazit.

Në mes të të ftohtit, që pagdhirë akoma, merrnin rrugën të pesë vullnetarët për të hapur taraca të reja. Tërë ditën punonin. Dhe kështu çdo ditë. Xha Llazi gjëzohej kur dëgjonte fjalë të mira për vajzën dhe për djemtë. «Furtunë fare është kjo Nikoleta», thosh ai. Në mbrëmje mblidhë vajzat e fshatit në vatrën e kulturës dhe organizonte biseda, takime, mbrëmje vallëzimi. Kish disa skeptikë që e shikonin shtrembër këtë punë. «Ç'janë këto mbrëmje tematike, vallëzimi?» thoshnin.

Ngritën grupin artistik. Deri vonë vazhdonte provat. Pastaj në kohën e lirë shkonin për të dhënë shfaqje në Gopesh, Strelckë e gjetkë. «Ç'vajzë?» thoshte i kënaqur xha Llazi.

Ajo shpejt mësoi të korrte grurin, të ngiste qetë. Në fillim xha Dajlani nuk desh t'i besojë qetë asaj.

— Nuk është për çupat kjo punë, jo, — i kish thënë.

— Të lutem, xha Dajlan, sa t'i ngas një herë!
— i qe lutur ajo.

Dhe ai ia kish lënë qetë.

— Oha, Oha! — e mësonte t'u bërtiste qeve.
Dhe Nikoleta pas xha Dajlanit klithete:

— Oha! Oha! — dhe qeshte plot çiltërsi.
E kush nuk i mbushi sytë me lot kur u larguan vullnetarët e uzinës mekanike!

— Mos na harro, Leta? Mirë? — i kish thënë xha Llazi.

Deri poshtë e ndoqën sytë e fshatarëve. Ishte përsëri muaji shkurt. Lanë prapa fshatin, dëborën, njerëzit që iu bënë aq të dashur.

Përséri në uzinë

Përséri midis tornosh, frezash, pjash. Përgjegjësi i repartit dhe sekretari i organizatës bazë të Partisë i dhanë Nikoletës me kënaqësi rekomandime për t'u pranuar si kandidate partie. Njëzëri të tërë komunistët dhanë pëlqimin që ajo të pranohej në Parti, se Partia për të tillë njerëz, për të tillë gjak të ri ka nevojë. Ajo vajza e drojtur e dikurshme ishte zgjedhur edhe kryetare e komitetit profesional të uzinës. Një vajzë që udhëhiqte një organizatë profesionale, ku shumica ishin burra?! Me simpati e shikonin të tërë. Por pati edhe nga ata që nuk u erdhi mirë kur muarën vesh se Nikoleta shoqërohej me një mjek nga Kolonja. C'ishte ky mjek që po ua merrte vajzën e tyre? Bile e kishin pyetur Nikoletën, ndërsa ajo vetëm buzëqeshte. Të ishte e vërtetë?

— C'ne ore, të martohet mjeku me një tornitorë? — kish thënë një punëtor.

— Pse ç'ka, ajo është me të gjitha të mirat — ishte përgjigjur tjetri.

Dhe Nikoleta, tornitorja e uzinës, u martua me të vërtetë me mjekun nga Kolonja.

Iku me të në Kolonjë. Ai mjek, ajo tornitore në SMT. Dhe e tillë mbeti: tornitore e dalluar, e

palodhur, e gatshme për të punuar detale për traktorët deri natën vonë, aktiviste e dalluar e bashkimeve profesionale. E ku nuk e gjen atë? Në krye të grupit punëtor, si të deleguar të këshillit të bashkimeve profesionale në organizata të ndryshme, në grupin artistik të SMT-së etj.

E tillë është Nikoleta, kjo tornitore e dalluar, kjo bijë e klasës punëtore.

NENESHTRIMI I PUSIT 632

Retë e dendura kishin sajuar mbi horizont një perde të hirtë dhe dukej sikur nga çasti në çast do të shpërthenin në një shi të furishëm. Dhe vërtet, pas pak nisën të bien disa pikë shiu, të rralla por të rënda.

Përgjegjësi i turnit ngriti kokën dhe e përqëndroi shikimin në horizontin e hirtë. Disa rrudha të holla u formuan në ballin e gjéré.

— E ku e gjeti pikërisht tani? — tha.

Naftëtarët e tjerë nuk u përgjigjën. Secili ngriti kapuçin e mushamasë së vet, sikur me këtë veprim të donte t'i thoshte përgjegjësit të turnit: «Epo le të bjerë, s'kemi ndër mend të presim gjersa të pushojë!»

Shiu aq i padëshirueshëm nisi të dendësohej. Era e fortë e shtynte atë sa në një drejtim në një tjetër. Fytyrat e naftëtarëve u lagën.

Ata iu afroan pusit 632. Beteja për naftë në pusin e ri akoma nuk kishte nisur. Ishin çastet më vendimtare. Duhej të përcaktohej me saktësi nëse kishte naftë pusi. Me sa dëshirë dhe ankth e prisin ata këtë çast! Nafta do t'u jepte fund lodhjes, pagjumësisë, vështirësive që ata kishin kaluar. Prej afro një viti, ata naftëtarë me fytyra të nxira nga

dielli e të rrahura nga era, luftuan me vullnet të çelniktë, punuan me kohë të mirë dhe të keqe pér të shpuar pusin, pér të shkuar drejt thellësive të mëdha të nëntokës, atje ku ishte fshehur prej shekujsh nafta, ai ar i zi.

Të gjithë ishin gati pér provën, pér të parë nëse kolona e shfrytëzimit ishte hermetike.

Manometri i aggregatit nisi të tregojë ngjitje. Shigjeta e presionit lëvizte ngadalë drejt shifrave më të larta. 130 atmosferë, 150, pastaj u ngjit 160, 170....

Manometri ishte në ngjitje, pra naftë do të kishte. Por ja, diçka lëvizi atje poshtë në thellësi, dhe pastaj gjithçka ndodhi aq shpejt, sa ata nuk arritën të kuptionin se ç'ngjau: shigjeta e manometrit lëvizi në drejtim të kundërt, duke rënë gjithnjë poshtë. Qëndroi tek shifra 30 dhe më nuk lëvizi, sikur dikush ta kish ndalur me dorë.

Inxhinieri-gjeolog, dhe përgjegjësi i turnit tjeter, panë njëri-tjetrin në sy. «Avari» u shkoi menjëherë mendja. Kjo nuk duhej të ndodhë.

Shiu vazhdonte të binte. Askush nuk fliste.

— Saracineskat a i kontrolluat kur i vutë? — theu heshtjen brigadieri.

— Unë i pashë vetë të gjitha — u përgjigj Spiroja.

— Duheshin kontrolluar mirë, — shfryu Myftari.

Spiroja pa thënë asnje fjalë, i ktheu shpinën dhe ia dha vrapt përmes shiut dhe baltës së madhe. Kur u kthyte, në duar mbante një tufë me saracineska.

— Tani t'i provojmë këto! tha me një frymë ai.

— Jo, Spiro, nuk është nevoja. Më fal që të fola ashtu. Fajin nuk e paskan saracineskat. Po ti ike

pa konkluduar mirë ne, — foli me zë të butë Myftari. — Ne i shternguam edhe më ato saraçineska dhe nuk rroddhi më asgjë prej tyre. Por megjithatë presioni mbeti po ai që ishte: 30.

Shiu u përzie bashkë me djersën e Spiros. Heshtje. Shiu rridhte me të shpejtë e nga mushamatë e naftëtarëve binte në tokën me baltë duke zgjeruar ato pellgje uji.

Pas pak prej pusit 632 u largua një «Gaz 69». Ai lëvizte me vështirësi nëpër atë baltë ngjyrë gri dhë lëkundëj sa në një krah në tjetrin nga gropat e rrugës. Në atë maikinë, të ulur pranë njëri-tjetrit nga të ftohtit, udhëtonin për në Qytetin Stalin Myftari me Spiron.

Në zyrën e kryeinxhinierit të kërkimit Nr. 1, u mblodhën specialistët e naftës.

— Hape, të lutem, atë dritare! — tha kryeinxhinieri.

Ata propozuan shumë variante të eliminimit të difektit, por më në fund u miratua si më i përshtatshmi dhe më i efektshmi: varianti i izolimit të ujit në kolonën e shfrytëzimit me anën e pakerit (një pajisje e posaçme tubash të gomuara në fund, të cilat do të hermetizonin të çarën).

Përsëri makina mori rrugën plot zikzake drejt pusit 632. Myftari dukej më i qetë në fytyrë, por Spiros nuk kishte gjë t'ia ndreqte fytyrën e prishur.

Pakerimi nisi që të nesërmen, por megjithatë izolimi nuk u bë, sepse ujët e kripur vazhdonte të vinte që nga thellësia. Kalonin ditët, njërin turn e zëvendësonte tjetri. Asnjë rreze shprese nuk po çante atë atmosferë të krijuar. Vazhdoi pakerimi i dytë. Përsëri asgjë. Vetëm me pakerimin e tretë kolona e shfrytëzimit u hermetizua. Nisi të dalë nafta, por edhe ajo me sasi të kufizuar.

— Naftë ka pak, duhen përmirësuar vëtitë kolatorale të gëlqerorit — tha kryeinshinieri, që kishte ardhur në vend për ta parë nga afër procesin e punës.

Propozimi i kryeinshinierit donte të thoshte që me anën e pompave me presion në shtresat e poshtme të pusit të hidhej acid klorhidrik me përzierje të tjera. Kështu do të krijohej e çara, nga do të dilte nafta.

Ishte ora 3 pas dite. Qielli ishte i qartë, pa asnje re. Turni i Kolit duhej të largohej e t'ia linte vendin turnit të Xhevdetit, por asnjeri nga ata naftëtarë nuk luajti nga vendi.

— Në qoftë se na lejoni edhe ne të qëndrojmë, shoku kryeinshinier do të bënët mirë, — iu drejtua atij Koli. Tani është fazë më kritike, kur kërkohen forca pune në preqatitjen e shpejtë të acidit me vaska.

— Po shokët e turnit ç'mendojnë, more Koli? Ata janë të lodhur.

— Të lodhur vërtet jemi, — ndërhyri aty për aty një ndër naftëtarët, — por edhe avaria duhet të likuidohet sa më parë. Nuk na rrihet në shtëpi, menjen këtu tek pusi 632 e kemi.

Kryeinshinieri i pa me dashuri ata naftëtarë, që kërkonin të qëndronin. Pastaj foli me kënaqësi:

— Mirë, pra, qëndroni. Kjo do të jetë lehtësi për ne.

Aggregatët dhe pompat e tyre ishin gati të viheshin në punë, ndërsa Fejziu me Enverin mezi prishnin të hynin në «skënë» për të lojtur «rolin» e tyre.

Duart lëviznin shpejt dhe njerëzit ishin të përqëndruar në punë, të heshtur, me nerva të tendosura e me fytyra serioze. Kërkohet një ritëm i lartë

pune, përndryshe rrezikoheshin të çaheshin vaskat prej fajance nga influenca e acidit të fortë.

— Gati, shoku kryeinshimier, pompat mund të thithin lëngun — tha Xhevabiri.

Makinat u ndezën dhe ulurima e tyre u shpërnda deri larg.

Acidi u fut në vaskat metalike të makinave. Nisi hedhja e tij me presion atje në thellësi. Kish filluar të ngrysej, por asnjërit nuk i shkonte mendja të largojhej nga vendi. Acidi futej deri poshtë, por ai, duke mos krijuar të cara, kthehej përsëri mbrapsht.

— Hej, djalli ta marrë! — shfrynte Fejziu.

E stakoi aggregatin dhe përsëri e ndezi. Manometri tregonte 180 atmosferë. Asnjë rënie!

— Vazhdoni! S'kemi q'të bëjmë, provën do ta çojmë deri në fund, — tha kryeinshinieri.

Vetëm pas tri orësh manometri ra nga 180 në 60 atmosferë.

— Ra presioni! — tha diçkush me zë të lartë.

Ja, pra, më në fund e cara u krijuua. Shtresa gëlqerore po thithte acid.

— Më shpejt hidheni acidim! — tha kryeinshinieri.

E gjithë sasia e llogaritur u hodh. Tani duhej lënë pusi për 24 orë, që acidi të bënte më mirë punën e tij. Ishte nata e 30 dhjetorit. Pra ata naftëtarë duhej të ktheheshin aty pikërisht në mbrëmjen e 31 dhjetorit.

Turni i Kolit me shokët e tij u paraqit në vendlindin e punës. Do të nxirrnin tubat e pakerimit.

— Hë, djema, si e ndieni veten? — iu drejtua shokëve Koli.

— Fare bukur! — u përgjigj një djalosh i ri i sapomartuar.

— Ashtu, ë? — e ngacmoi Koli. — Po gruaja s'të tha ç'është kjo punë pikërisht natën e Vtitit të Ri?

— Jo, jo! «Nxirrni naftën ju, pa sa për natën e Vtitit të Ri e bëjmë edhe tjetër herë. Ku ka gëzim më të madh se të punosh për naftën në një natë të tillë!» Ja, kështu u përgjigj ajo.

Koli u gëzua nga një përgjigje e tillë. Të tillë ishin naftëtarët, gjithnjë të gatshëm, në çdo kohë.

— Fillojmë, djema? — tha brigadieri.

— Po, brigadier, — u përgjigjën njëherësh disa zëra.

Dhe nisi puna në atë natë të ftohtë dimri, atëherë kur edhe pak orë do të vinte Viti i Ri. Kishin nxjerrë dy gjatësi tubash, kur Koli ndjeu erën e gazit dhe ardhjen e naftës. Ai u hodhi një shikim të shpejtë dy naftëtarëve, Asllanit dhe Hysenit.

— More djema, a e ndieni erën e gazit apo jam gabim?

Pa marrë përgjigjen ky, nga tubat nisi të dalë nafta e cilësisë së lartë. Në fytyrat e tyre u pasqyrua gëzimi. Sytë u shkëlqenin fort. Në të tilla raste manovrimet për heqjen e tubave duheshin pezulluar menjëherë dhe saraçineskat të mbylleshin.

— Shpejt, djema, shtërngoni saraçineskat — tha Koli me të shpejtë.

Dhe sa tha këto fjalë, ia dha vravit në këmbë për të lajmëruar në telefon dezhurnin e ndërmarrjes. Vendì i telefonit ishte larg. Vrapoi shpejt nëpër ato rrugë tërë baltë. Kur mbërriti në vendin e telefonit, u ul një çast, sa për t'u çlodhur pak. Pastaj mori numrin plot emocion.

— Alo, dezhurni je?

— Po. Kush je?

— Koli jam.

— Gëzuar Vitin e Ri, more Koli, gëzuar!
— Gëzuar dhe ti naftën! Dëgjon? Naftën, —
iu dridh buza Kolit.

— C'naftë ore, fol, si është puna?
— Ja si është puna. Lajmëro shokët, se pusi
632 po jep naftë të mrekullueshme. Ik tani! Miru-
pafshim!

Koli ishte djersitur. Fshiu ballin dhe qafën.
«Naftë! Naftë! A s'ishte ky urimi më i mirë pér
shokët, në vigjiljen e Vtit të Ri?

Lajmi gazmor u pérhap menjéherë. Kryeinxhi-
nieri, Myftari e të tjerë morën rrugën e largët
drejt atij pusit 632. Çante me shpejtësi rrugët ma-
kina. Dhe udhëtarëve të kësaj nate të vrërët sepse
po u dukej kjo natë më e gjatë e sikur s'kishte
të sosur kurrë.

— Po jepi një çikë, vëllaçko, jepi! — i tha
shoferit Myftari.

Kur mbërritën në pusin 632 pérpara u dolën
naftëtarët. U qeshte buza. Ata e kaluan këtë natë
larg tavolinës familjare, por pér këtë nuk u vinte
aspak keq, sepse sofër më të bukur, më të pasur se
nafta kù kish për ta. U përqafuan njëri me tjetrin.
Nuk ishte një pus i zakonshëm, por i pasur në naf-
të, i një cilësie të lartë.

Xhevahiri i futi duart në atë naftë, i lau me të,
dhe duke qeshur iu drejtua shokëve:

— Hë, si ju duket nafta? — por, pa pritur pér-
gjigjen e tyre, shtoi: — flori ore, flori, pér besë!

— Ja ç'dhuratë të bukur i dhamë Partisë e sho-
kut Enver, djema! Ju lumtë! — tha kryeinxhinieri.

Dikush fshiu sytë. Një tjetri iu drodhën buzët.
Ishin çaste emocionante pér të gjithë. Po, sepse ki-
shin fituar një betejë, betejën pér naftën.

«TEUTA» ÇAN PËRMES DALLGËVE

Gjurmët e një lufte të ashpër me dallgët e egër-suara, me erën e stuhishme në Detin e Zi dhe detin Egje duken akoma në kuvertën e vaporit «Teuta». Kripa e detit ka ndryshkur tubat e gjatë të importuar për industrinë e naftës. Valët e tërbuara kanë prishur dyshemenë rrëth urës së kapitenerisë, kanë shkëputur mbrojtëset e gadinave të spirancës, kanë luajtur dhe çarë arkat e litarëve të trashë. Gjurmët e përlleshjes dukeshin edhe në fytyrat e marinarëve tanë, fytyra si të derdhura në bronc, burrërore, por të lodhura nga vështirësitë e pagjumësia.

C'kish ndodhur me anijen «Teuta» gjatë udhëtimit të saj nëpër det të hapur që nga Kostanca, Varna e deri në Durrës?

...Edhe pak orë duheshin që «Teuta» të linte portin e Varnës. Ishte një ditë e ftohtë marsi. Mbi qiellin e Detit të Zi retë kishin sajuar një çarçaf ngjyrë gri. Frynte një erë e fortë dhe e ftohtë, që të përthante fytyrën. Të qëndronin apo të niseshin? Kjo ishte pyetja që dukej silkur i mundonte aq shumë ata marinarë sypatrembur.

Kapiteni i anijes kishte rënë në mendime. Çfarë të papriturash do t'i sillte udhëtimi po që se nise-

shin? Po në qoftë se qëndronin në port pa dalë? Sa duhej të prisnin atëherë? Sa ditë humbje do të kishin në realizimin e planit? Këto pyetje e mundo-nin. Atyre u duhej dhënë përgjigje. Kapiteni hodhi sytë nga kuverta e anijes, andej ku me radhë ishin vendosur tubat dhe arkat e ndryshme.

Në kuvertë kishim qëndruar disa marinarë. Kapiteni iu afrua dhe i pyeti:

— Si thoni, shokë? Nisemi apo qëndrojmë në port?

— Nisemi më mirë. Mbase pushon era — tha me plot bindje një marinar.

Xhevdeti, kështu quhej kapiteni i anijes, bëri disa hapa të ngadalta në kuvertën e anijes. I ftohti të hynte gjer në palcë. Pastaj qetë-qetë iu drejtua shokëve të tij marinarë:

— Po qe se ju jeni gati, atëherë nuk na mbetet gjë tjetër veçse të ngremë spirancën.

Dallgët sa vinin po tèrboheshin më tepër. U ngritën spirancat. «Teuta» mori rrugën e largët në detin e dallgëzuar. Ishte një mëngjes i errët, i zymtë në portin detar të Detit të Zi.

Vetëm pas disa orë udhëtimi nisën tallazet, lë-kundjet. Kapiteni qëndronte i heshtur në postin e drejtimit. Ishte i përqëndruar dhe me shkathësi mundohej të manovronite për të mënjanuar goditjet e valëve anash.

— Kapiten, mos na ço në rrugën me «gropa», se komunalja nuk i ka ndrequr akoma! — bëri shaka njëri nga marinarët.

Xhevdeti buzëqeshi me ëmbëlsi, por vështrimin e tij nuk e largoi nga ato dallgë të rrezikshme. Ato ishin të gjata dhe të larta. Njëren valë e ndiqte tjetra, më e fuqishme. Tubat e shumtë që kishin ve-

ndosur me aq kujdes në kuvertën e anijes tanë po lëviznin duke u përplasur njëra me tjetrën me zhurmë. Marinaret kishin përqëndruar shikimet e tyre të shqetësuara andej nga tubat.

Kapitenit të anijes iu afrua një djalosh bjond, me trup të lidhur. Ky ishte oficeri i parë, Vasfiu.

— Xhevdet, tubat po lëvizin si shumë. Si do të bëjmë?

— Për to po mendoj. Duhet të zgjojmë edhe marinaret e turnit tjetër. Duhen përqëndruar forcat.

«Teuta» i përngjante një nëndetëseje që futej e dilte nga uji.

Në kuvertë u dukën marinaret që kishin punuar tërë natën dhe tanë me sy të përgjumur u bashkuan me shokët e tjerë për të shpëtuar ato tuba dhe arka që deti kërkonte t'i përpinte. Dallgët përplaseshin në kuvertë me zhurmë.

— Kur të vijë dallga tjetër, mos luani nga vendi! — tha oficeri i parë, që ndodhej mes marinareve, atje, për të mbërthyer tubat.

Marinaret ishin lagur nga dallgët që përplaseshin pa mëshirë mbi ta.

Ata tashmë luftonin pa fjalë. E dinin se fjalët ishin të tepërtë në këto çaste. Vetëm ndjenja e përgjegjësisë për mallin e popullit i bënte ata marinaretë trima të luftonin dhëmb për dhëmb me atë det të egërsuar, me ato dallgë të tërbuara, që kërkonin të mbillnin shkatërrim, që kërkonin viktima dhe prë në «mbretërinë» e tyre të detit.

«Jo, xhanëm, jo! S'jemi nga ata burra që të dorëzohemi ne — mendoi Petraqi, marinari më i ri i «Teutës». — Turfulla sa të duash, more det i zemë—

ruar!» dhe Petraqi, bashkë me të tjerët luftonte pér të mbërthyer arkat më mirë me kavon e çeliktë.

Deti oshëtinte nga një zhurmë e frikshme. Dukej sikur vinte nga thellësitë e mëdha ajo zhurmë. Marinaret shihnin njëri-tjetrin. Ishin serioze ato ftyra. Ata kishin marrë përsipër një barrë shumë të rëndë, por që duhej ta përballonin me çdo kusht.

Qielli ishte errësuar nga retë e dendura, që vareshin deri poshtë. Era ulurinte me një zë të frikshëm, kurse dallgët e zemëruara shfrynin me forcë të madhe iñatin mbi anije. Një dallgë e lartë, që erdhë me shpejtësi, hodhi me një forcë të çuditshme qindra metra tutje njërën nga mbrojtëset e gadinave të spirancës.

— Mbrohuni! Ulni kokat! — u dëgjua përmes altoparlantit zëri i qartë, i fortë, por pak i ngjirur i kapitenit. Ai kish marrë një mikrofon në dorë dhe që nga ura e kapitenerisë drejtonte punimet pér sigrumin e tubave dhe të arkave.

Paralajmërimi i një furtune më të madhe ishte i shpejtë, por edhe reagimi i marinareve po aq i shpejtë. Vecse dikush u rrëzua në kuvertë nga dallga. Një tjetër iu hodh me shpejtësi në ndihmë dhe e ngriti.

Ai që ishte rrëzuar kishte qenë vetë nostron Llazari. Ai ishte tërë nerva nga kjo e papritur që i ndodhi dhe ku pa? në sytë e marinareve më të rinj!

— Ta marrë e mira, ta marrë! — shfryu. Pastaj, duke dashur të zbusë sadopak atmosferën e krijuar, shtoi: — Ku vajti e më ndodhi kështu mua në sytë e të tjerëve?

Por është nuk e pati mendjen te fjälët e tij. Ndofta nuk i dëgjuan mirë pér shkak të zhurmës së madhe të dallgëve.

Petraqi nuk e ndiente veten mirë. Sikur i përzihej.

«Edhe kjo më duhej!» mendoi.

Anija lëkundej tashmë si një gogël sa djathtas majtas. Edhe dyshemeja herë ngrihej e herë ulej. Për të qëndruar, marinaret duhej të mbaheshin diku.

«Me siguri nja shtatë ballë do t'i ketë deti sot», i shkoi ndër mend nostromit.

Pamja ishte tepër e vështirë. Asgjë nuk mund të shikohej tutje dy miljeve.

Një dallgë e lartë mbuloi tërë kuvertën. Vasfiu, oficeri i parë, u ndodh në befasi. Dallga e përplasi. Desh kaloi tutje bortit të anijes, por duke ruajtur gjakftohtësinë u kap pas kavos së çelniktë. Duart iu gjakosën, por nuk e lëshoi kavon.

Asnjë dallgë, asnjë vështirësi nuk i lëkundi marinaret tanë. Tubat e lidhur sërisht tani lëviznin më ngadalë. Kavot e bënë punën e tyre — rreziku ishte mënjanuar. Dallgët le ta vazhdonin punën e tyre.

Xhevdeți i shihte me simpati ata marinare tripla, që megjithëse e kishin kryer detyrën për të sigeruar tubat dhe arkat, nuk po largoheshin, ndërsa dallgët vazhdonin t'u përplaseshin në trup.

— Shokët e turnit të natës të largohen! — tha ai që lart, — Të tjerët të ngrohen, të ndërrohen dhe të çlodhen!

Marinaret lëvizën me përtessë drejt kabinate të tyre. Mes tyre ishte edhe Vasfiu. Duart e gjakosura i kishte lidhur me fasho.

«Teuta» eci me shpejtësinë e zakonshme. Drejt Durrësit afroheshin me shpejtësi.

— Ja ku dukët Durrësi! — tha tërë gjëzim njëri ndër marinaret e riqj.

Të gjithëve iu duk sikur iu hoq një barrë e

rëndë që i mundonte. Në fytyrat e dobësuara u ravigjëzua kënaqësia. Atdheu i tyre ishte fare pranë.

Ne u takuam me këta njerëz në njërën nga sallat e anijes. Pranë nesh ishin kapiteni dhe komisari i anijes. Ata na treguan për këtë udhëtim të vëشتirë, plot të papritura.

— Çdo gjë harrohet, edhe e keqja, — nisi të flasë marinari i ri, Petraqi.

— Kur isha i vogël gjithnjë kam ëndërruar të bëhem marinar, por në Detin e Zi dhe Egje kuptova me të vërtetë se ç'do të thotë të jesh marinar. Shokët talleshin me frikën time. Epo sigurisht, ata janë regjur në det! Kanë kaluar sa e sa prova. Për mua kjo ishte prova e parë me vështirësi. Deti të mësoka me vështirësitë — përfundoi Petraqi.

Të tjerët qeshni, ndërsa ai vazhdonte akoma të fliste. Pas pak në sallonin e gjerë të «Teutës» undie lëvizja e marinareve. Ata po bëheshin gati për të zbritur në tokë. Në nuk duhej t'i pengonim më tepër dhe u ndamë si miq me këta njerëz të thjeshtë, të dashur dhe më vullnet të hekurt.

NE ORTIN «42»

Era e fortë frynte pa pushim. Zhurma e saj dëgjohej qartë dhe në kapanonin ku po flinin minatorët. Kanatet e njërsë dritare nisën të lëvizin nga pak dhe më në fund ato u hapën duke u përplasur herë me njëra-tjetërën e herë pas murit.

— Kush e la atë dritare çelë? Mbylleni, he burra! — u dëgjua përmes asaj zhurme zëri i një minatori të përgjumur.

— Mbylli ishte, por era e hapi, — u dëgjua një tjetër.

— Qenka tërbuar sonte. S'do të na lërë të pushojmë! — tha me zërin prej basi një minatori veteran. Dhe u ngrit ta mbylli dritaren.

Nga jashtë dëgjohen hapa, e zëra. Pas një çasti dera e kapanonit hapet.

— O Dodë, Dodë! — bërtiti një minatori i turnit të tretë.

— Ç'keni, he burra? Përse nuk e lini Dodën me fjetë? — ndërhyri minatori që mbylli dritaren.

— Dodë këtu, Dodë atje! A s'mund të bëni pa të?

— Por ai është përgjegjës, e kur bllokohet furrneli duhet me qenë në vend edhe ai.

— Cili furrnel është bllokuar?

— I tridhjetepesti, ai në ortin «42».

— Oh, më i rëndësishmi! — thá minatori vëteran dhe iu afrua Dodës, që nuk po merrte vesh së ç'bëhej rrëth tij.

— Sa është ora? Jam vonuar, — tha më të shpejtë Doda nëpër gjumë.

— Jo, jo nuk je vonuar, por është bllokuar tridhjetepesa.

— Aha, njitash po çohem! — tha Dodá dhe u çua me disa lëvizje energjike.

Jashtë bënte ftohtë. Era iu përplas menjëherë në fytyrë minatorëve. Toka ishte bërë kallkan nga ngricat dhe këmbët kërcisnin me zhurmë nëpër atë tokë të fortë si gur. Doda ecte me hapë të shpejtë duke i lënë pak mbrapa shokët e tij. Në galéri u fut i pari. Brenda bënte më ngrohtë. Fytyrë e Dodës, e skuqur dhe e ngrirë nga nxitimi dhe të ftohit, sikur u zbut atje në galeri.

Minatorët e turnit të tretë, kur e panië, morën frymë lirisht. Shikimet e tyre u përqëndruan tek Doda. Dukej sikur secili thoshte në këto çaste! «Ja, erdhi Doda, çdo gjë do të shkojë mirë».

— Duhet të hyj brenda rië furrnel! — tha prej Doda. Me lëvizje të shpejta dhe të mësuara u lidh më bel me litar. Pastaj nxori nga një xhep i fshehtë teserën e Partisë.

— Shoku Dedë, na, mbaje teßerën!

Deda, sekretari i organizatës bazë të Partisë, u prek. «Gjithmonë i pari në sakrifica dhë i fundit në pretendime! i shkoi atij në mendje parullë e Partisë. Ai ishte i sigurt se edhe po ta ndalonte, Doda dë t'i përgjigjej: «Dikush duhet të hyjë, përsë mos ta bëj unë»?

Pas kësaj Doda u zhyt në furrnelin 32 metersh të thellë, që i ngjante një pusë. Ai kishte hyrë dhe

herë tē tjera nē furrnel. Nē një zbritje tē tillë kishte plagosur këmbën nga një gur që e kishte goditur fort. Tanimë kishte eksperiencë. Pas pak ai tundi litarin që nga poshtë. Kjo donte tē thoshte «térhiqmëni». Doli i lagur nga uji dhe i përlyer nga balta. Vetëm sytë e mëdhenj dukej sikur lëshonin rreze drite.

— Vendi asht bllokue keq. Janë rrëzuar edhe trarë. Bakri e ka mbuluar, e është krijuar më duket një shtresë e trashë. Duhen vendosur minat, ndryshe nuk kemi gjë nē terezi. Kanë me m'u dashtë katër minatorë me hapë birat.

— Doda bëri një pauzë, e, pasi i pa me kujdes shokët, shtoi:

— Veçse një gjë dua me ju thanë, brenda është ftohtë, baltë ka me bollëk dhe ujët depërtón. Nuk dua tē jap asnijë urdhër, puna është me vullnet. Edhe unë do tē punoj me ata që do tē zbresin poshtë.

Heshtja zgjati shumë pak, vetëm disa sekonda. Minatorët panë njëri-tjetrin nē sy. Ata e dinin se do tē punonin nē kushte tē vështira, tē lidhur me litar, do tē hapnin me baromina bira për plasjen e minave.

— Do tē futem unë, — ndërhyri Prenga. Zëri i tij ishte i vendosur. Ky ishte fugisti i turnit.

— Edhe unë, — tha Gega.

— Më merrni edhe mua, — tha një minator i ri.

Doda nuk e priste që ai minatori i ri tē dilte vulnetar. Nuk ishte futur asnijëherë nē furrnel. Kjo ishte kalitja e parë me vështirësitë.

— Mirë, lidhu me litar — tha i gëzuar përgjegjësi i turnit. Do t'ia dalim mbanë, — tha me bindje

të plotë. — Të tjerët të shkojnë në furrelin tjetër, që të mos qëndrojnë pa punë.

Doda e shokët e tij u lëshuan njëri pas tjetrit brenda në furrel. Duhej të hapnin 16 bira në atë bllok të ngjeshur bakri, dheu dhe balte. Pas pak u dëgjua goditja e barominave. «Gum... Gum... Gum... kërcisnin barominat. Minerali mund të shembej nën këmbët e tyre, por katër minatorët e rrinë pa pushim dhe me kujdes atë masë të metaltë. Llamba elektrike ndriçonte zbatë fytyrat e tyre. Ishin bërë qull nga ujët që rridhte nga të plasurat e furrenit. Doda ngriti llambën dhe i drejtoi sytë andej nga gryka e furrenit. Dy minatorë kishin zgjatur kokat sikur të donin të depërtionin me shikimin e tyre atje poshtë, në thallësinë e madhe të furrenit. Shqetësoheshin përfatim e shokëve. Vetëm pas dy orëve, Doda tundi litarin. Do të ngjiteshin, birat ishin gati. Ai doli i fundit nga furreni, pasi kishte ndezur minat me fitil të gjatë. Ngjitja u bë e shpejtë. Ai e të tjerët u tërroqën tutje grykës së furrenit.

Pas pak u dëgjua një plasje e mbytur. Doda vajti shpejt për të parë rezultatin, por mbeti i ngirrë në vend. Nga plasia nuk kishte rënë asnjë copë bakër. Furreni ishte akoma i bllokuar.

— C'mund të ketë? — tha me inat Doda.

— Ti mos u mërzit, he burrë! Do t'i hapin prapë birat — i tha Prenga.

— S'e kam fjalën aty. Nuk i përtoj, se unë zbres prapë poshtë, por ne kemi pezulluar prodhimin.

Katër njerëz u futën përsëri në furren. Dy orë të tjera pune. Pas plasjes së dytë vetëm disa copë minerali ranë poshtë. Përsëri dështim. Ashtu siç ishim të lodhur e të rraskapitur, dolën jashtë.

— Do tē pimë diçka nē bufe pér me u ngrohë. Pastaj prapë nē furrnel! — tha me zë tē lodhur Doda.

— Po, po, mos ki merak! — e qetësoi Gega.

Pér tē tretën herë u futën nē furrnel. Dështimet njëri pas tjetrit nuk e kishin mposhtur vullnetin e tyre. Përsëri nisën tē zhurmonin barominat me atë gum-gumin monoton. Balta dhe uji rrighthn trupat dhe fytyrat e minatorëve.

Doda përsëri doli i fundit nga furrneli. Vetëm kur furrneli u zbras krejtësisht nga minerali pas plasjes së tretë, vetëm atëherë sikur u çlirua nga një ankth i madh. Këmbët iu prenë, por e mbajti veten.

— Tashti, ti Tomë e Ndue, bëni përforcimet e armaturës.

— Mos kij dert, Dodë. Shkoni tash, se fjalën e kemi ne — iu përgjigj Ndueja.

Katër minatorët bashkë me Dodën shkuan nē banjë, atje brenda nē galeri. Kur dolën, kishte rënë mbrëmja. Kurbneshi llamburiste nga dritat. Ecen me hapa tē ngadalta mbi tokën e ngirrë kallkan.

— Tash do tē çlodhemi mirë, he Dodë?

— Po, e kemi hak, apo jo?

Kishin kaluar një ditë tē vështirë dhe tē lodhshme.

... mënyr mësim jashtë agj së përmes qëllimit
dorëgë e ndiqur me kogn çilësht është se ne vëllëzim
nëpër një rreth qëndroq e shqipërisë. Por kjoç përmendur është
vëllëzim qëndroq i rrethit që dëshiron që t'jët e bëjë
një qindje më e madhe. Nëpërmjet kësaj qëndrëzimit
nëpër një rreth qëndroq e shqipërisë ka dhënë qëllim
një qindje më e madhe. Por kjoç përmendur është
VENDOSMËRI KOMUNISTE

Rulat, në të cilat mbështetej furra lëvizëse e
pjekjes së çimentos, ishin çarë. Ato duhej të hiqe-
shin dhe të zëvendësoheshin me të tjera. Por zëven-
dësimi i rulave mund të bëhej vetëm po të pritej
ftohja e furrës, e cila zgjaste plot dy javë. Nuk
ishin pak! Dhjetëra, bile disa qindra tonë çimento
nuk do të transportoheshin nëpër objektet e ndërtimit
të atdheut tonë.

Bajrami, brigadier i elektricistëve dhe sekretar
i organizatës bazë të Partisë, dukej i menduar. Ai
**e dinte se q'vendim do të merrnin remontierët: të
bënин remontin e nxeh të rulave, të punonin në
kushte të vështira, në një temperaturë të lartë, të
duronin afshin e nxeh të dhe të padurueshëm të
furrave. Dhe ja, si vullnetarë për të hequr rulat
dolën Sinani dhe Shyqyriu.**

Bajrami s'kishte si të kundërshtonte kur ata
ngulnin këmbë aq shumë «Ç'njerëz»! mendoi.

— Hajt, drejtoste pompën e ujit nga ne! — i tha
Sinani shokut të tij.

Ai po lagej para se t'u afrohej rulave të nxeh të
që duheshin hequr e zëvendësuar. Pas pak një rrymë
e fortë uji lagu trupat e dy remontierëve të pa-
lodhur. Dhe ashtu të lagur siç ishin, me ujet që u

rridhte çurkë nga koka, nga teshat, nisën punën. Bajrami shihte se si thahej ujët në trupin e tyre, si u shkonin djersët palë-palë e pastaj përsëri lage-shin me ujë për të rifilluar punën e nisur më parë. Me sa këmbëngulje punonin! Bajramit iu mbësh-tuall një lëmsh në grykë, tek i shihte ata si punonin me aq ndërgjegje me aq vendosmëri dhe guxim. «Asnjë vështirësi nuk i ndal dot njerëzit tanë!» mendoi.

Pranë tij u afrua Nikolla, inxhinieri mekanik i fabrikës. Edhe ai e hodhi shikimin atje ku zëven-dësoheshin rulat. Që të dy qëndronin pa folur. Dukej sikur mendonin për të njëjtën gjë. Plani i pro-dhimit mezi realizohej që kurse zëvendësuan gazin me qymyrguri.

— Ç'sakrificë! — ndërhyri në bisedë Nikolla.

— Po! E megjithatë rendimenti i prodhimit qëndron akoma i ulët, më poshtë nga kufiri i projektit, — tha Bajrami.

— Po, po, 6-7 kv. cimento më pak në orë. Epo nuk është përfajin tonë. Janë arsyen objektive.

Sekretari i Partisë e pa me vërejtje. Inxhinieri i uli sytë. Pastaj u ndanë. Por Nikolla, që nga ai çast, e humbi qetësinë. «Si, xhanëm, nuk po bëjmë dot gjë për të ngritur rendimentin?» shqetëso-hej ai. Dhe nisi të mendohet. Diçka, e vagelluar në fillim, i lindi në kokë. Përsëri iu afrua furrës, hapi një bisedë me punëtorët rrëth vendosjes së zinxhi-rëve në furra e pastaj shkonte në zyrën e tij e qëndronte deri vonë. Kështu bënte ngahera. Deri vonë drita nuk shuhej atje.

— «Ç'bën ky njeri kështu? — mendonte sekretari. Një turrë me libra ishin shpërndarë në tavolinën e tij.

— Më ka lindur një mendim, por nuk e kam kristalizuar akoma — i tha një ditë Nikolla.

— Po hë de, i mirë është? — e pyeti sekretari.

— Për të mirë mundohem. E kam hallin të ngremë rendimentin.

— Aha, ja si qenka puna! Bukur fort!

Dhe Bajrami ulej në një karrike, shfletonte edhe ai ndonjë libër e pastaj largohej për ta lënë të qetë Nikollën.

— Bisedo edhe me punëtorët. Ata kanë përvojë në këtë punë — i thosh sekretari.

Dhe Nikolla vërtet ashtu bënte. Bisedonte gjatë me ta, bënte debate, i pyeste, u merrte mendim dhe përsëri ulej në tavolinën e tji.

Kaluan disa javë pune intensive. Nikolla dukej i lodhur dhe i dërrmuar nga netët plot shqetësimë e pa gjumë. Më në fund ai i tregoi Bajramit projektin e tij.

Bajrami e mori në duar projektin. U zhyt thellë në mendime, bëri pastaj disa pyetje sqaruese. Mendimi i Nikollës iu duk i guximshëm.

— Siç e sheh, unë parashikoj të bëhen riven-dosja e zinxhirëve brenda në furrë, të ndërrohet sistemi i tyre i vendosjes. Këtë do ta bëjmë në kohën e rimontit kapital të fabrikës.

Si do ta prisnin të tjerët këtë propozim? Dhe reagimet negative u dukën qysh në fillim.

— Ç'thoni, more vëllezër? Ç'rikonstruksion e rivendosje zinxhirësh na propozoni? Hajde, hajde! Ne po na vjen festja vërdallë me planin, kurse ju thoni «rikonstruksion». Lërnani rehat, vëllezër! — u ishte përgjigjur një shok me përgjegjësi në drejtori.

— Mirë xhanëm, të thërrasim edhe specialistët!

Të shohim ç'mendim kanë ata — kishte ngulur këmbë sekretari i Partisë!

— Urdhëro! Le të vijnë, pos! Po unë e di qysh tani mendimin e tyre! Kot e kini, — tha shoku i drejtorisë.

Dhe vërtet erdhën specialistë nga disa fabrika cimentoje të vendit tonë. Diskutimet ishin të shumta. Pati pro dhe kundër. Atëherë u detyrua të ngrihej përsëri Bajrami.

— Këtu dëgjuam mendime të ndryshme, — nisi të flasë qetë-qetë ai. Më shumë u shprehën kundër projektit të inxhinier Nikollës. Pati nga ata që shkuan edhe më larg: të cilët propozuan t'i dërgojmë një shkresë Ministrisë së Ndërtimit të na ulet plani i prodhimit për «arsye objektive», siç u shpreh njëri këtu. Ka mundësi që shokët e ministrisë të miratojnë propozimin tonë për të ulur planin e prodhimit. Kjo mund të ndodhë. Por unë desha t'ju pyes juve, shokë specialistë dhe shokë të drejtorisë: A është e drejtë të propozojmë të ulim planin e prodhimit të cimentos? Ne e dimë sa nevojë për cimento kanë objektef e ndërtimit, që po ngrihen kudo në vendin tonë. Për mendimin tim, ai shok që bëri këtë propozim nuk e ka vënë politikën në plan të parë. Ndërgjegjja jonë komuniste nuk duhet të na e lejojë një gjë të tillë. Sa për projektin e inxhinier Nikollës unë shprehem në favor dhe kam besim të plotë se ai do të dalë me sukses.

Dhe Bajrami u ul në vend i skuqur paksa nga ai diskutim plot zjarr.

— Por ama edhe eksperimente nuk na lejohet të bëjmë, shoku sekretar, jo! Kush e merr përgjegjësinë në qoftë se ne dështojmë? — ndërhyri me forcë një nga anëtarët e këshillit teknik.

— Ne, komunistët, të gjithë! Dhe do t'i themi haptas Partisë: ja, u përpinqëm, vramë mendjen, humbëm kohë, u shqetësuam e u lodhëm, por këtë radhë dështuam. Po, po, këtë radhë, se pastaj do ta gjejmë me çdo kusht rrugën për të ngritur rendimentin.

— More shokë, le të flasim shtruar, — u ngrit të flasë një inxhinier nga fabrika e çimentos së Fushë-Krujës. — Ju, shoku Bajram, e shoh se jeni përkrahës i flaktë i propozimit të inxhinier Nikollës. Por, pa më thoni, — shtoi ai me ironi, — pa më thoni, inxhinierët që e kanë projektuar më parë këtë fabrikë nuk e kanë pasur parasysh atë që thotë inxhinier Nikolla? Ma merr mendja që firma e huaj nuk na ka lënë shteg për të vepruar ne. I ka parashikuar të gjitha.

— Ja, kjo është krejtësisht e gabuar, shoku inxhinier. Më duket se po përkulen i pak si shumë përpura teknikës së huaj. Mos i nënveftësoni mundësitë dhe aftësitë e specialistëve tanë, — tha Bajrami.

— Në radhë të parë, i dashur shok, matu me shprehjet e mos na fut në kallëpe të tilla. Dhe së dyti unë nuk thashë se i nënveftësoj aftësitë profesionale të njerëzve tanë.

— Më duket, shoku inxhinier — u hodh e tha Bajrami — ju po flisni pa u thelluar mirë në projektin e inxhinier Nikollës. Nuk e njihni atë hollësish.

Nikolla qëndronte i heshtur e po dëgjonte këtë duel midis sekretarit të Partisë dhe inxhinierit nga Fushë-Kruja. Mirëpo dikush propozoi që të fliste edhe një herë inxhinier Nikolla. Prandaj ai u ngrit.

— Unë, jo vetëm që jam i bindur se rikonstruktionin mund ta arrijmë me siguri, por mendoj edhe

se do tē arrijmē tē bëjmë rritjen e shpejtësisë së rrrotullimit tē një furre.

— Ashtu! — tha pa u përbajtur inxhinieri. — Nga sa sekonda nē sa?

— Unë mendoj që rrrotullimi i furrës tē ulet nga 57 sekonda pér xhiro nē 47 sekonda.

— Ha-ha. Ç'po na thua! — ia priti inxhinieri nga Fushë-Kruja. — Por a ke menduar se ç'do tē ndodhët atëherë nē sistemin mekanik tē furrës? Sepse dihet që rulet e vendosura janë llogaritur pér tjetër shpejtësi. Me sa duket ti kërkon tē na e nxjerrësh furrën jashtë përdorimit!

— Mos u ngutni, inxhinier, tē shprehni mendime që padashur ju çojnë nē gabime. Ju lutem mos flisni nē këtë mënyrë! Përse flisni me kaq siguri?

— Epo edhe ne nuk hamë bar. Dhe, me sa di unë, kot nuk më keni thirrur nē mbledhjen tuaj, apo jo?

— tha ai me ironi.

Nuk iu dha përgjigje. Megjithatë shumica e pjesëmarrësve tē mbledhjes së këshillit teknik u shpreh kundër projektit tē inxhinier Nikollës.

— Natyrisht këtu nuk është thënë fjala e fundit. Atë do ta thonë komunistët, punëtorët.

Nikolla dukej i dërrmuar shpirtërisht.

— Nuk ia dalim dot nē krye pa ndihmën e drejtorisë, jo. Unë po e tërheq propozimin tim, Bajram!

Pa shih, pa shih! I ngrite duart! Po tërhiqesh?

Bajrami heshti pak dhe, si u mbush mirë me frymë, vijoi:

— Jo, Nikollë. Projektin tēnd dō ta diskutojmë edhe nē organizatën bazë të Partisë, dō tē dëgjojmë se ç'thonë komunistët.

Po atë ditë u mblohdh byroja e organizatës bazë të Partisë të fabrikës së çimentos «V.I. Lenin», ku Bajrami bëri propozimin të mblidhej organizata bazë e Partisë.

Ajo qe një mbledhje e jashtëzakonshme. Njëri pas tjetrit të gjithë komunistët u shprehën për rikonstrukcionin, për idenë e inxhinier Nikollës.

Pastaj Nikolla e Bajrami vajtën e biseduan shtruar edhe me punëtorët e furrave.

— Ideja është e mirë dhe e guximshme, — tha një ndër punëtorët. — Ne na ke me vete. Do ta bëjmë natën ditë, dhe projektin do ta realizojmë.

— Në qoftë se dalim keq me planin, boshllëkun do ta plotësojmë bashkë — u shpreh Foni.

Bajramit iu ngroh zemra. Masa e miratoi mendimin. Organizata bazë e Partisë kishte pasur të drejtë kur kishte thënë: t'u drejtohem i punëtorëve, atyre që do të kryejnë rikonstrukzionin.

Komunistë e punëtorë pa parti u vunë në lëvizje për të bërë rikonstrukzionin. Komiteti profesional u vu në krye të punës propagandistike për vendosjen e parullave të ndryshme, fletërrufeve për punëtorët më të mirë, për propagandimin e punës, për rikonstrukzionin. Herë pas here nga qendra e zërit flisnin punëtorë të ndryshëm. Ata zotoheshin të bënin jo vetëm rikonstrukzionin por edhe rimonitin e mesëm njëkohësisht.

Prova e fazës së parë, të eksperimentimit saktesoi vërtetësinë e mendimit të inxhinier Nikollës dhe të vendosmërisë së sekretarit të organizatës bazë të Partisë dhe të komunistëve të tjerë. Ishtekaluar kufiri i përcaktuar nga projekti i projektuesve të fabrikës duke u prodhuar 6 kv. çimento më shumë në orë.

Nikolla e Bajrami vetëm tani, pas një kohe të gjatë lufte të vazhdueshme mendimesh e nervash, u qetësuan. Bajrami i shtrëngoi dorën me dashuri dhe simpati të thellë Nikollës.

— Të lumtë, vëlla, na ke bërë një punë të mrekullueshme, me të vërtetë krijuese!

— Ehe, more Bajram, po të mos kisha pasur mbështetjen e fortë të organizatës-bazë të Partisë dhe të punëtorëve as që do të kisha bërë gjë. Do të kishte triumfuar mendimi konservator.

Bajrami dukej tepër i lodhur.

— Dhe tani na duhet të vazhdojmë fazën e dytë të eksperimentimit, të përfundojmë edhe rikonstrukcionin e furrës së dytë.

— Pa dyshim, Nikolla.

Dhe ata u ndanë nga njëri-tjetri. Kishte fituar këmbëngulja dhe vendosmëria komuniste.

PERSERI NË FRONTIN E PUNËS

Xha Dashoja, pensionisti 65 vjeçar e cte me hap të ngadalshëm nëpër ato rrugë plot dredha të fshatit Zusë. Ai mori drejtimin nga fabrika e cimentos e Shkodrës, atje buzë lumi Bunë. Ja ku dukej ajo së largu: tymi shtëllunga-shtëllunga ngjitej në qellin e kaltër.

Ka pesë vjet që është shkëputur nga fabrika e cimentos, por zemrën e ka atje, në fabrikë. Me të janë lidhur gjëzimet, shqetësimet dhe sukseset e tij. Se nuk i thonë shaka të punosh 36 vjet rrësht në një vend. Çdo kënd i fabrikës është shumë i dashur dhe i zgjon kujtime të ndryshme. Qysh kur doli në pension ai ka ardhur shpesh në këtë fabrikë, për të bisuar me punëtorët, për të parë si punojnë ata, si punon ai punëtori i ri që i mori stafetën. I kundron-te me një farë lakmie ata punëtorë të rinj dhe herë-herë, kur e merrte malli për punë, merrte lopatën në dorë, e mbushte disa herë me qomyrguri dhe e hidhte në furrë. Pastaj i pëlqente të shtynte vagonin me gur, argjil ose qomyrguri. Punëtorët e vështro-nin me simpati e dashuri këtë punëtor të vjetër, që kish punuar me ndërgjegje të lartë për aq vite. Sa herë ata kishin dëgjuar të flitej për të nga më të vjetrit, sa gjëra u kishin treguar për punën e tij, për

ndërgjegjen në punë, për vendosmërinë dhe guximin e tij!

Tek ecte me atë hap të qetë, xha Dashoja dukej si i menduar. Njerëzit që kalonin rastësisht andej e përshëndesnin plot respekt këtë burrë të moshuar me flokë të zbardhura, me fytyrë të çiltër e shumë fisnik. Edhe xha Dashoja u përgjigjej me respekt duke hequr kasketën ngjyrë kafeje nga koka. «Nadja e mirë!», «T'u rrittë ndera!» etj.; ndonjërit edhe i shtërgonte dorën fort e pastaj vazhdonte rrugën e tij.

Atë ditë ishte çuar herët, më herët se zakonisht. Dhe askush nuk është se ku po shkonte. Por Dashoja natyrisht nuk mund t'i thoshte të gjithëve, se po shkonte në fabrikë. Ai kish dëgjuar se nga fabrika kishin dalë 27 vullnetarë për të shkuar e jetuar përgjithmonë në kooperativën e Oblikës. Ata i ishin përgjigjur thirrjes së Partisë.

«Po unë, si pensionist, ç'duhet të bëj në këtë caste? A nuk mbetet vendi i tyre i punës bosh? Posi! Do të mbetet bosh. Edhe unë duhet të bëj diçka, më gjithësë jam pensionist» mendontë në shtëpi Dashoja.

Kish marrë një vendim. Të shkohite në fabrikë është thoshte: «Dua të punoj për sá kohë që vendi i 27 vullnetarëve do të mbetet bosh, se fabrika nuk duhet ta pakësojë prodhimin e cimentos për asnjë çast.» Po përsëri ngurronte. E kjo vinte jo së në fabrikë mund të lodhej, se do të prishte qetësinë e pensionistik. Jo, aspak. Atë e hante vëtëm një mërrak: Po shokët e fabrikës ç'do të thonë vallë? Si do ta presin propozimin e tij? Ai nuk donte që ndonjëri të mendonte se ja, xha Dashoja e bëni këtë për lekë, që të ketë përfitim personal, të marrë shpërblim

suplementar mbi pensionin e tij. Këto mendime e shqetësime nuk e linin rehat. Por më në fund kishte vendosur. Le të mendojnë ç'të duan. «Unë nuk jam nga ata burra që koritem për lekë» kishte menduar.

Po ecte me këto mendime në kokë dhe as dëgjoi se si e përshëndeti një punëtor.

Punëtori duke buzëqeshur u largua. Tani xha Dashoja i ishte afruar fabrikës. Ai u habit sa shpejt e kish bërë këtë rrugë atë ditë. Por ama djersët ia kishin mbuluar ballin e rrudhur.

— A janë mbledhë të tanë punëtorët?

— Po, axhë. Aty janë... Po ti pse?...

Xha Dashoja nuk i dha përgjigje këtij punëtori kureshtar, që me atë pyetje kërkonte t'i zbulonte sekretin që mbante fshehur.

Askush nuk u çudit kur e pa xha Dashon të hynte në sallën e mbledhjes. Ai kish ardhur edhe herë të tjera kur diskutoheshin probleme të prodhimit!

— Hajde, hajde, ulu këtu! — i tha një punëtor veteran.

Dhe ai u ul, pasi hoqi kasketën dhe e vendosi mbi gjunjë. Atë ditë do të përcilleshin 27 vullnetarët për në fshat. Drejtori i fabrikës e mori fjalën. Ai përshëndeti këta përfaqësues të klasës punëtore që po i përgjigjeshin thirrjes së Partisë. Pastaj u ngritën disa vullnetarë njëri pas tjetrit. Xha Dashoja i dëgjonte më vëmendje dhe emocionohej nga fjalët e tyre. Ata premtasin se do ta çonin në fshat frymën e klasës punëtore, disiplinën, rregullin dhe organizimin e saj. «Sa mirë! mendonte xha Dashoja.

Ishte krijuar një atmosferë prekëse, Kur të gji-

thë menduan se mbledhja ishte aty nga fundi, xha Dashoja ngriti dorën e tha:

— Me leje!

Tërë vështrimet e punëtorëve u kthyen nga ai. Xha Dashos i erdhi zor në fillim nga ky përqëndrim i shikimeve. Fytyra iu mbulua nga një ngjyrë e kuqe. Edhe fryma iu duk sikur iu muar.

— Fol, xha Dasho, fol! — e nxiti drejtori kur pa një farë drojtjeje tek ai.

— Desha me i thanë nja dy fjalë, o shokë!... Këta shokë po bëjnë një punë shumë të mirë, që po shkojnë në kooperativë. Por ama një gjë dua t'u kërkoj: të punojnë si në fabrikë... të na mbajnë nderin e klasës punëtore,...

— Mos kij merak, xha Dasho! Do të dalim faqe-bardhë... — u përgjigj njëri ndër vullnetarët.

— Tash kam një propozim. Mos ma merrni ters, he burra, e?

— Jo, jo! foli duke buzëqeshur sekretari i organizatës bazë të Partisë.

— Fabrikën e dua si veten, prandaj dua të punoj për aq kohë sa të gjeni të tjerë puntorë që të zëvendësoni vullnetarët e fshatit... Se prodhimi nuk duhet pakësuar asnjë grimë.

Në sallë kishte rënë qetesia. Të gjithë ishin përqëndruar tek ky njeri tërë thinja në kokë e rrudha në fytyrë. Këtu ai kishte kaluar pjesën më të madhe të viteve të tij. E nisi jetën si punëtor qysh i ri në fabrikën e cimentos, në këmbët e Taraboshit plak. Punonte që nga mëngjesi e deri në mbrëmje për një kafshatë bukë në fabrikën e pronarit. Asnjë ditë gëzimi nuk pa, vuajtja dhe hidhërimi mbushnin ditët e tij. Disa herë bënë grevë për kushtet e punës, disa herë sabotuan prodhimin' në kohën e pushtimit

nazifashist. Vaso Kadia, që punonte me xha Dashon, e frymëzonte, i hapte sytë për të kundërshtuar dhunën dhe shfrytëzimin. «Do të vijë një ditë që do të jetojmë ndryshe, kur do të bëhem ne, punëtorët, zotër të fabrikës», i thosh shpesh militanti komunist. Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Krejt ndryshe rroddhi jeta e tij në vitet e pushtetit populor. Ai punoi me gjithë shpirt për t'i dhënë popullit sa më shumë çimento, që të ringriheshin urat e rrënuara, shtëpitë gërmadha. E në qoftë se edhe Shkodra, qyteti i tij i lindjes, ishte mbushur tërë shtëpi shumëkatëshe, fabrika e uzina, kopshte e spitale, një ndihmë kish dhënë edhe ai, xha Dashoja, me çimenton e tij.

Xha Dashoja gëlltiti pështymën dhe, duke dashur të prishë qetësinë e vendosur, shtoi:

— Mos mendoni se e bëj për lekë, jo! Besanuk dua asnjë shpërblim... se fabrikën e kam timen... Ja, kështu...

E kishin mbuluar djersët. Punëtorët po e shikonin me shumë dashuri. Ata ishin prekur nga fjalët dhe qëndrimi i xha Dashos. Pastaj, kur e pa se nuk kishte për të shtuar gjë, tha:

— Kaq patë...

Në sallë shpërthyen duartrokitjet. Dikush fshiu edhe lotët që, padashur, e kishin tradhtuar. Tani tek të gjithë pasqyrohej gjëzimi. Shumë veteranë të fabrikës i vajtën pranë dhe e përgëzuan xha Dashon për vendimin e tij...

— Të lumtë, e ke bërë si burrat! — i tha njëri ndër ta.

Dhe iku pastaj për në shtëpi. Të nesërmënveshi rrrobat e punës dhe, pa zbardhur akoma drita, u drejtua nga fabrika e tij.

Roja e fabrikës, kur e pa u habit:

— S'të paska zënë gjumi, he burrë! As pesë nuk ka shkuar ora.

= Pata geif t'i takoj ata tē turnit tē natës.

= Mirë, mirë si të duash...

Përgjegjësi i turnit, Hamdiu, i doli përpara. Ia shtërgoi dorën miqësish pensionistit.

— Mirë se erdhe, xha Dasho, — i tha ai.

— Nadjë e mirë!

— Erdhe, a!

— Po, besa, s'më ka zënë gjumi imbrëmë.

— Ku do tē punosh?

— E si të them? Unë i njoh të gjithë sektorët...

= Mirë, pra, do të punosh te furrat...

Xha Dashoja hyri me një ndjenjë gëzimi në fabrikë. Iu afrua furrës dhe ndjeu se zemra nisi t'i rrahë me të shpejtë. Sytë iu njomën. Já, këtu në këtë vend, kishte punuar ai vitet e fundit para se të dilte në pension.

«Përsëri këtu» mendoi, pastaj sikur i dha kurajë vetes «Mbaje veten Dasho, si burrat, mos të t'i shohin lotët të tjerët, se është turp»; pastaj, meduart muskuloze, kapi lopatën e nisi të hedhë në mënyrë ritmike qymyrin në grykën e zjarrtë të furrës. E kur furra u ngop me lëndë djegëse, xha Dashedos nuk i rrihej më në një vend. Shkoi të shihet si ngarkoheshin vagonat me gurë e árgjil. Aty kishet edhe disa punëtorë të rinj.

— Kuides, djema, ruajini këmbet nga vagonat!

— pastaj, së bashku me ta, shtyu vagonin pranë
furrës së tharies së gurit dhe të argjilit.

Përsëri u ndodh pranë grykës së furrës. Futi një hekur të gjatë për të shtyrë mirë qymyrin, që të digjët në mënyrë uniforme. Ishin sekretet e zanatit që Dashoja i kishte mësuar prej vitesh.

Ardhja e pensionistit i dha një vrull më të madh punës. Të rintjtë nuk deshën të mbeteshin mbrapa xha Dashos.

Ditën e dytë të punës të xha Dashos në fabrikë u duk edhe një pensionist tjetër. Ky ishte Myrtoja.

Pas pesë vjetësh shkëputjeje ata ndien përsëri afshin e punës dhe thyen kështu qetësinë dhe monotoninë e jetës pensioniste.

Dhjetë ditë qëndruan atje. Koha e largimit erdhë. Në fabrikë kishin ardhur forca të reja punëtore. Drejtoria dhe komiteti profesional i fabrikës, përparrë se të largohejshin të dy pensionistët, organizuan një takim me punëtorët.

Shumë fjalë të mira, të ngrohta dhe miqësore shprehën punitoret e fabrikës së cimentos. Pensionistët nuk mundën të thoshnin asnjë fjalë, sepse nuk i linte mallëngjimi.

ZEMRA TË FLAKTA

Një makinë çante me shpejtësi rrugën drejt Tiranës. Rënia pandërprerë e burisë paralajmëronte këlimtarët dhe shoferët e automjeteve të tjera të hapnin rrugën dhe të kishin kujdes. Njerëzit largoheshin anash dhe mundoheshin me një shikim të çastit të kapnin të aksidentuarin, që ndodhej në kabinën e shoferit. Por ishte e pamundur, sepse kamioni kalonte përpara si shigjetë. Ç'kishte ndodhur vallë? Cilët ishin ata njerëz që nxitonin drejt spitalit?

I aksidentuari ishte në gjendje të rëndë. Që i ri u fut në SMT-në e Tiranës për të mësuar profesionin e mekanikut, por në punë e sipër pësoi një aksident duke u djegur në flakë. Djegia ishte e rëndë, mbi 50 për qind. Jeta e tij ishte në rrezik të madh.

Një bisedë e shqetësuar

Kujtimi, saldator në oficinën e SMT-së, kishte ngritur jakën e xhaketës dhe me shikimin e hedhur diku larg, jashtë dritares së autobuzit dukej sikur diçka bluante në mëndje. Shiu binte papushim në ato fusha të gjera. Një shok aty pranë i foli, por ai

nuk e pati mendjen. Pastaj ndjeu që dikush e preku për shpatulle. Ai sikur u përmend dhe u kthyesh prapa:

— Myfit, tu qenke?

— C'je zhytur thellë në mendime?

— Nesër do t'i bëhet operacioni plastik Gencit.

— E di, do të shtrohemi për t'i dhënë lëkurë, unë. i jati dhe daja e tij.

— Do të shtrohem edhe unë, — foli Kujtimi.

Atij nuk i shkrepri ky mendim papritur. Në punë ishte ustai i tij i rreptë dhe njëkohësisht i dashur, kurse tanë ndërgjegja e tij proletare i thotë se duhet të plotësonët edhe këtë detyrë shoqërore. Ditën kur u dogj Genci, ai ishte hedhur i pari në flakë. Hoqi xhaketën, trikon e leshtë dhe e mbështollë nxënësin e tij, por flaka e ndezur nuk u shua, benzoli nuk shuhet lehtë dhe tanë ai me gjakftohtësi po nisej drejt spitalit.

— Ndofta do të qëndroj deri në fund të muajit

— i kish thënë së shoqes.

Dhe ish nisur i përcjellë nga shikimi plot admirim i saj.

Çanga

Në sektorin e qendrës së SMT-së dikush i rachaçangës. Zhurma tingëlluese e saj ishte si një kushtrim. Përse binte kjo çangë? Një punëtor ndaloit tornon, një tjetër la nga duart saldatriçen, të tjerë dolën nga oficina mekanike. Edhe uturima e traktoreve të fushës u ndal. Punëtorët shpejtuan hapat, çanga i thërriste. Fytyrat e tyre dukeshin të menduara.

140 punëtorë dhe punëtore, të veshur me komi-

noshet e punës, u grumbulluan në klubin e SMT-së.

— Shokë, mbani qetësi! — foli me zërin e tij të fortë kryetari i komitetit profesional. — Ju e kini marrë vesh që një shok i ynë punëtor, gjatë punës u aksidentua rëndë. Nga ne kërkohet ndihma e menjëherershme. — Ai u ndal për një çast dhe i hodhi një vështrim asaj turme punëtore. — Nuk kërkohet ndihmë materiale, jo aspak, fjala është se ne duhet t'i dhurojmë shokut tonë pjesë nga trupi ynë, pjesë të lëkurës sonë.

— Jemi gati, jemi gati! — u dëgjuan fuqishëm shumë zëra nga salla.

— Kërkohet që dhuruesi të jetë i ri — vazhdoi ai përmes asaj zhurme miratimi të punëtorëve.

— Mos bëni dallime, kjo është punë që s'bëhet! — u dëgjua një zë tjetër.

— Me leje shokë, me leje! — u dëgjua zëri i Xhavitit, që këto ditë u pranua anëtar partie. — Kuptohet fare mirë që të gjithë ne duam t'i dhurojmë shokut pjesë nga mishi ynë, sepse të gjithë ne na ka mësuar Partia dhe shoku Enver me shpirtin e solidaritetit proletar, me shpirtin e sakrificës dhe të vetëmohimit, por pasi Genci është punëtor i ri, unë mendoj se atij i duhet lëkurë e re.

— Është e qartë shokë? — foli përsëri kryetari i komitetit profesional.

“U caktuan 40 vetë që do të niseshin për në spital.

— Të tjerët në punë! — foli dikush me zë autoritar.

Megjithatë në autobus hipën edhe punëtorë të tjerë që u bashkuan me ata të 40-tët.

Operacioni

Kirurgu doli me hap të nxituar në korridorin e gjatë të pavionit Nr. 1 të Spitalit Nr. 2 të Tiranës.

— Përse më thirrët?

Më shumë se 40 punëtorë kanë ardhur të dhurojnë lëkurë. Janë të SMT-së.

Kirurgu nuk u përgjigj menjëherë. Ai u prek dhe u emocionua. Kjo nuk ishte e zakonshme në praktikën e tij si kirurg. Këta punëtorë, me dëshirën e tyre, me vullnetin e tyre kishin ardhur për t'iu nënshtuar operacionit, për të hequr pjesë nga trupi i tyre. Shoku ndodhej në rrezik dhe ata me thirrjen e parë të ndërgjegjes, erdhën këtu.

— Por ndofta nuk është nevoja për një sakrificë të tillë, — foli kirurgu me një zë që i dridhej. — Ne kemi të jatin, dajën e tij, dhe Kujtimin. Këta mjaf-tojnë.

— Shoku doktor! Ne nuk heqim dorë nga vendimi ynë — tha një punëtor — ne jemi shokët e tij. Ai u aksidentua në punë. Ne jemi të rinj, kurse i jati është i moshuar. Prandaj mirrni pjesë nga lëkura jonë.

Beqiri, i jati i punëtorit të aksidentuar u mëllengjye tek dëgjonte zërin e vendosur të atyre punëtorëve, tek shihte këtë solidaritet të mrekullueshëm punëtor.

Kirurgu nuk mundi më të kundërshtonte. Edhe atij iu përlotën sytë.

— Le të bëhen analizat, nuk i largojmë dot, — tha doktori tjetër, që u afroa në atë çast.

Për të dhruuar lëkurën e tyre kishte ardhur edhe Latifi me të shoqen e tij, Dritën. Ata porsa kishin mbushur dy javë martesë.

Më 19 dhjetor, 17 punëtorë të SMT-së u futën në sallën e operacionit. Dikujt i pritej një copë lëkurë nga këmba e djathtë dhe dikujt nga e majta. Të gjithë duruan dhembjet e operacionit. Qëllimi i lartë nuk i përfilli aspak dhembjet.

— Ti, Xhavit, qëndro. Do të hyj unë në vendin tënd, je më i dobët fizikisht nga unë. Të lutem më lë radhën mua të hyjë, — i foli një shok i punës.

— Ç'më lutesh kot? Këtë e punë e kam vendsur, nuk e kthej fjalën. Do të operohem — foli me një zë të prerë Xhaviti, sekretari i organizatës së rinisë së SMT-së, dhe u fut në sallën e operacionit.

O p t i m i z ë m

Genci i kish fare pranë ata shokë të tij të dashur, që po bënин çmos pér t'i ardhur në ndihmë, i dëgjonte zërat e tyre optimiste, të qeshurat, bisedat. Dhe i vinte t'u hidhej, t'i përqafonte, t'i puthte me dashuri dhe t'ua shtërgonte duart fort.

I takuam këta punëtorë në një nga dhomat e spitalit. Dikush bënët shaka, të tjerët qeshnin. Ata dukeshin si ushtarë të plagosur në front në një përpjekje pér të shpëtuar shokun e tyre. Dhe nuk ka lumturi më të madhe kur lufton pér jetën e shokut.

— Ky është Kujtimi, shakaxhiu ynë, — tha Sotiri. I kanë hequr një copë lëkurë të madhe në bark dhe dy copë në të dy këmbët dhe prapë nuk i lë shakatë. Por ama kur qesh shumë, vetëm atëherë ta shikoni si shtrembërohet në fytyrë.

Ndërkohë në dhomë hyn kryeinfermieri.

— Si ndjehi bre burra?

— Mirë, mirë, ndërhyri Gavrili. — Ne që nesër do të shkojmë në aksion për hapjen e një kanali.

— Ç'hotë ky? — Ngre supet i habitur kryein-fermieri.

— Jo, jo, nuk i lë njeri të shkojnë në aksion — e qetësoi atë kryetari i komitetit profesional, Përparimi. — Ne i kemi marrë masat që punën e tyre ta bëjnë shokët e tjerë. Do të bëjmë 14 m³ kanal më shumë.

Ne ecim korridorit të gjatë me kirurgun Petritin. Ai na flet me një admirim të madh për këta punëtorë.

— Është një solidaritet i mrekullueshëm punëtor. Këtë ngjarje nuk do ta harroj kurrrë. Vetëm një parti si e jona mund të kalisë dhe të edukojë njerëz të tillë.

Ky është humanizmi ynë revolucionar.

«KONFLIKT» MIDIS SHOKESH

Sadiku, brigadier i minatorëve tunelistë kishte dalë në grykën e tunelit, po dëgjonte ata njerëz që këndonin, që i binin fort daulles, curles dhe fizarmonikës. Ishte Sabriu, brigadier i tunelit të Hotolishtit me shokët e tij, që vinte për t'i marrë flamurin stafetë të garave. Edhe të tjera minatorë lanë punën. Iu afroan Sadikut. Të gjithë ishin ngrysur në fytyrë. Për katër muaj me radhë nuk ua kishte marrë dot njeri flamurin. Ishin ndeshur me shkëmbinjtë, e kishin copëtar me «dhëmbë» atë masë të gurtë dhe ishin bërë shembull për tërë brigadat e tuneleve në ndërtimin e hekurudhës Librazhd-Prrenjas.

— Nuk ua japim flamurin, sidoqë të bëjnë — ia pat një minator me inat.

Sadiku e pa-me dhembje shokun e tij, pastaj nënqeshi lehtas.

— A je ku je, o Sadik! — ia pat tërë gëzim Sabriu, që sapo zbriti nga makina. — A e ke preqatit flamurin me na e dhanë?

— Flamurin e keni merituar dhe qe ku e keni. Merreni — foli me zë të ulët brigadieri.

Të dy brigadierët ia dhanë dorën njëri-tjetrit miqësisht. Pamja e tyre ishte krejtësisht e ndryshme: Sadiku i vrenjtur si në një ditë me shi, ndërsa Sabriut i shkëlqente fytyra prej gazit. Sadiku i pa tek u lar-

guan. Makina e tyre mori me vete këngën, harenë; dhe mbi të gjitha flamurin stafetë të garave. «Partisë i premtojmë hekurudhën ta ndërtojmë» — buçiste rruga. Këto fjalë përplaseshin në male e kodra duke jehuar herë pas here të fuqishme.

Që atë ditë Sadiku bisedoi edhe me dy brigadierët e turneve të tunelit N°1 dhe N°2. Kërkoi një mbledhje urgjente të 50 minatorëve të tre turneve. Minatorët lanë tunelet, lanë pistoletat e martelët dhe u ulën këmbékryq në tokë, atje në të dalë, në tunelin N°1.

— E patë si iku flamuri? — nisi të flasë me një zë pak si të ngjirur Sadiku.

— Epo kemi pasur edhe arsyе objektive, shoku brigadier. Atyre nuk iu shemb shkëmbi dy-tri herë si ne — foli nga vendi një minator.

Sadiku hodhi vështrimin andej nga erdhi zëri. Ishte një minator i ri dhe shumë i shkathët. Nuk desh t'i përgjigjej menjëherë. Ai e dinte se rrëzimi i shkëmbit në tunel dhe hapja e një «gaverne» dhjetë metra të gjerë dhe 14 metra të lartë që nga mali e brenda në tunel, krijoi një vështirësi të papritur për brigadën e tyre. Por nuk ishte vetëm kjo. Për të rifituar kohën e humbur ata kishin puñuar natë e ditë nën ujin e vazhdueshëm që rridhët nga brendësia e malit, kishin puñuar me vetëmohim pér të mbushur boshllëqet e krijuara në realizimin e planit. Brigadieri i hodhi një shikim Njaziut, që drejtonte në tunel makinën vetëshkarkuese. Me sa heroizëm kish puñuar ai, sa vështirësi kish kaluar! Vetes i kish vënë një qëllim: të largonte sa më parë gurët e rënë në tunel nga mali. Nuk përfilli gjumin, lodhjen, vështrësitë. E sa të tjerë kishin përballuar vështirësi akoma më të mëdha!

— A nuk është e drejtë t'u kërkojmë llogari edhe shokëve të drejtorisë së transportit, që në vend të tre-katër makinave na prunë vetëm një? — foli që nga vendi një minator tjetër. — Po neglizhenca e disa shokëve të oficinës në riparimin e automjeteve? Unë mendoj se edhe këta na kanë penguar në realizimin në masën e duhur të planit.

— Me radhë, shokë, pa konfuzion — foli Sadiku dhe pastaj vijoi. — Propozoj që të bëhet një ballafaqim midis punëtorëve të tuneleve dhe shokëve të drejtorisë së transportit të oficinës së riparimit.

Më parë t'u vihet një fletërrufe — u dëgjua një zë.

— Dakord, — t'u bëhet fletërrufeja, u përgjigj Sadiku. — Por mua më duket se duhet të rishikojmë edhe punën tonë. Si jemi me disiplinën e punës, me shfrytëzimin e kohës së punës? A ka sorollatje?

Turnet e Sadikut, të Dalipit dhe të Shuaipit zakonisht dallosheshin për një disiplinë të çeliktë. Megjithatë brigadierët e turnit mendonin se kishin akoma rezerva të brendshme.

— Më duket se ka ardhur koha të rishikojmë zotimet tona, — tha Njaziu. — Ja, për shembull, unë zakonisht e bëj evadimin e materialeve të shpimit nga galeria për 12 orë. Unë propozoj që këtë ta realizoj në pësë orë më pak.

Për një çast u krijua një qetësi. Pastaj mbledhja e organizatës profesionale sikur mori zgarr.

— Unë zotohem që pregatitjen dhe betonin e kallëpit ta bëj jo më në 32 orë si më parë, por në 24 orë — tha Lisimaku.

— Edhe unë — ndërhyri Lutfiu, — nga 12 orë që është kam shpimin e 120 birave, do t'i bëj në 7 orë: Sadikut, që është edhe kryetari komitetit prof-

sional të tuneleve, iu ngroh zemra. Po bëheshin propozime konkrete. Dhe ai e dinte fare mirë se njërezit e tuneleve kur e japid fjalën e mbajnë. Një ditë më parë ata kishin punuar edhe një material të rëndësishëm të shokut Enver Hoxha. Ky material i kishët frymëzuar ta shihnin me syrin kritik tërë punën e tyre.

— Ne deri tani kemi bërë gara mes sektorëve, por kjo s'mjafton, — tha Sadiku, — Përse të mos krijojmë gara edhe midis turneve? A nuk do t'i shërbëjë kjo qëllimit tonë të shtojmë fitoret, të rimarrim flamurin?

Turnet e Sadikut, të Shuaipit dhe të Dalipit u transferuan në sektorin e Pishkashit. Ishte një terren i vështirë. Makinat për çeljen e tuneleve nuk mund të përdoreshin për shkak të formacionit të dobët të shkëmbit. Llogaria duhej të bëhej tani vetëm në forcat e krahëve, në organizimin e brendshëm të punës, në disiplinën e çeliktë proletare.

Sadikut i lindi një mendim. Atë ua tha edhe shokëve të tjerë, të cilët e miratuan menjëherë. Në mes të tunelit do të vendosnin një flamur të kuq. Duke filluar nga të dy anët e tunelit minatorët do të bënин garë se kush do të mbërrinte i pari të merrte flamurin. Ishin 45 metra nga secila anë për të mbritur në qendër të tunelit.

Zotimet e marra i vendosën në hyrje të tunelit. Cdo mëngjes shifrat dhe zotimet u dilnin parasysh. «Sa e realizove normën sot?» «Si e shfrytëzove kohën?» — këto ishin pyetjet që i bënin njëri-tjetrit. Por mbi të gjitha minatorët i brente shqetësimi se kush do të mbërrinte më parë në qendër të tunelit.

Dhe pastaj u bënë llogaritë e tërë kësaj pune. Zotimet e tyre i kishin thyer disa herë. Planin, megji-

thëse iu desh të punonin në gjysmën e kohës pa makineri, e kishin realizuar 112 pér qind. Tunelistët e Hotolishtit i kishin lënë më mbrapa.

Në një ditë plot diell, mes rrugës tërë pluhur u nis makina pér në Hotolisht. Sadiku e shokët e tij gjithë gaz e hare po venin pér të rimarrë atë flamur stafetë që kishin humbur një muaj më parë. E panë flamurin tek valëvitej. Tunelistët e Hotolishtit e kishin vendosur në majë të një shtylle metalike.

— Ngjitu e merre! — iu drejtua Sadiku një djaloshi të shkathët.

Ai u ngjit si një mace e shpejtë. Por flamuri nuk hiqej kollaj. E kishin lidhur fort.

— Nuk hiqet, — foli djaloshi që lart.

Sadiku i hodhi një shikim zbirues patriotit të tij nga Peshkopja, Sabriut, brigadierit të tunelistëve hotolishtas. Ky i fundit qëndronte i heshtur.

— Pse e lidhët aq fort? Apo mos kujtuat se do ta mbanit përgjithnjë?

Brigadieri i tunelistëve nuk u përgjigj. Ai pak kishte hallin e flamurit që ia merrnin! Edhe shokët e tij ishin po aq të mërzitur.

Brigada e Sadikut ishte shend e verë. Nuk përmbaheshin nga gëzimi.

— Mirë u pafshim në dhjetor! — tha qetësisht Sadiku.

Buçiti daullja. Minatorët e Pishkashit nën ritmet e gëzuara të daulles, çiftelisë dhe klarinetës ia nisën një valleje mu para sheshit, në të cilin më parë ishte ngritur e valonte krenar flamuri stafetë. Pastaj

të qeshur, të gëzuar e plot zhurmë u nisën përsëri drejt Pishkashit.

Dy brigadierët, shokë qysh në fëmijëri nga Peshkopja, e vështruan njëri-tjetrin një copë herë të madhe. Midis tyre ishte hapur tashmë një garë e vërtetë, e cila do t'i hidhte në aksion e beteja akoma më të mëdha.

P E R M B A J T J A

Faqe

Trimat e pamposhtur të Miliskajës	3
Ndërgjegje proletare	16
Dashuria për shokun	20
Punëtorë të thjeshtë me ndërgjegje të lartë	25
Njerëz të hekurt	29
Minatorët e heshtur të Qyrsaqit	34
Heronjtë e frontit të zjarritë	40
Të vendosur të thyejnë çdo blokadë	46
Kjo ndodhi në Lladomericë	51
Metalurgu	58
Rruga e një tornitoreje	66
Nënshtimi i pusit 632	71
«Teuta» çan përmes dallgëve	78
Në ortin «42»	84
Vendosmëri komuniste	89
Përsëri në frontin e punës	96
Zemra të flakta	104
«Konflikt» midis shokësh	110